



Gazeta Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, Viti i XXIV i botimit, nr. 274, Gusht 2026

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër, Tel. +355685000229, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktore: Klodjana Serraj, Çmimi 100 lekë / 1 euro

KUSHË MICJA

- 167 VJETORI I HAPJES SË SHKOLLËS SË VAJZAVE
NË QYTETIN E SHKODRËS -

12

Shumë është shkruar për hapjen e kësaj shkolle dhe nismëtares e saj Marie – Kushë Micja. Madje, me rastin e 100 vjetorit të themelimit të kësaj shkolle, në vitin 1959, Komiteti Ekzekutiv i K. P. të qytetit Shkodër vendosi një pllakë përkujtimore në shtëpinë e saj, me këtë mbishkrim: “Në këtë shtëpi u hap e para shkolle femnore në Shkodër, në vitin 1859, me emnin shkolla e Kushë Mices, shkolla kje qe për 45 vjet me radhe u ba qendra e përhapjes s’ arsimit në çetën femnore në qytetin e Shkodrës”.

Mbas vitit 1961, rrugica është restauruar, dhe me këtë rast është prishur shtëpia e Kushës dhe megjithëse është shkruar për te nuk është vendosur asnjë shenje për ta kujtuar këtë shkolle apo themeluesen e saj, Kushë Micja, kur në kominën e Gjilanit, në lagjen “Arbëria” është rrugica me emrin “Kushë Micja”!!!

Kryesia e Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, në bashkëpunim me Bashkinë Shkodër, Drejtorinë e Shkollimit Shkodër, me datën 5 shtator 2026, dite e Shtune, në ora 10.30 do të inaugurojnë vendosjen e pllakës përkujtimore për këtë shkolle dhe autoren e saj, duke zhvilluar një veprimtari të veçantë.

Prof. Kristo Frashri: Dukagjinët futen në zotërim malet në anën e djathtë të Drinit!

2

Sipas prof. Kristo Frashri, Dukagjinët futen në zotërim malet në krahun e djathtë të Drinit (Historia e e Skënderbeut fq. 102-103-104). Zotërimi i Dukagjinëve, dikur i papërfillur, tani në vitet ’20 të shekullit XV ishte në fuqizim të vazhdueshëm në Shqipërinë Veriore. Disa historianë pretendojnë se ata ishin fisnikë me origjinë shekullore, por argumentet nuk janë bindëse. Fillimet e familjes së Dukagjinëve janë shumë të ngjashme me ato të shumicës së familjeve të tjera fisnikërore shqiptare. Ato duhen kërkuar në viset e thella malore, ku krerët lokalë me përkrahjen e bashkësive të lira malësore u rezistuan prirjeve feudale që vinin nga bregdeti, duke u bërë vetë krerë feudale patriarkale të fuqishëm, aq të fuqishëm sa filluan ta shtrinin sundimin e tyre drejt Perëndimit për të dalë, deri sa dolën, në bregdet.

Kryqi që ringjall kujtesën e një fshati të harruar

Në Kodër Shën Gjergj, pranë kishës me të njëjtin emër, tashmë ngrihet një kryq 10 metra i lartë, që shihet nga larg dhe që synon të bëhet simbol i kujtesës, besimit dhe shpresës. Përrurimi i tij u bë më 17 gusht 2026, në njësinë administrative Shosh, në Bashkinë Shkodër. Kryqi metalik është vendosur mbi një bazament të ndërtuar me kujdes dhe i pajisur me ndriçim, duke e bërë të dukshëm edhe gjatë natës.

3



Kardinali Ernest Troshani, ish-burgu i Spaçit, të persekutuarit e komunizmit dhe Zoti Trump

6

Para disa ditësh u zhvillua në oborrin e burgut të Spaçit një meshë e mbajtur nga Kardinal Ernest Troshani. Akuza e përpiluar në zyrat e sigurimit të shtetit e arrestimit ishte se ai kishte kremtuar një Meshë të Shenjtë për shpirtin e Presidentit të ndjerë amerikan John Fitzgerald Kennedy. Ish-burgu i Spaçit në Mirditë u kthye të premten në një vend pelegrinazhi dhe kujtese. Pas dekadash, në vendin ku vuajtë 12 vite burg gjatë regjimit komunist, u rikthye eminenca e tij Kardinal Ernest Simoni Troshani. Me të mbërritur atje, ai vizitoi ambientet ku ishte mbajtur i burgosur dhe u ndal pranë fotografive të ish-bashkëvuajtësve, duke kujtuar vitet e persekutimit dhe sakrificën e qindra të dënuarve politikë.



Kundër drejtimit burokratik të shkollës

- SHKOLLA NË FOKUSIN E
GAZETARIT -

Problemet e drejtimit të shkollës moderne janë bërë të vështira. Sepse shkolla është bërë një institucioni më kompleks në të cilin kanë ndryshuar rolet, pozicionet dhe janë transformuar konceptet e shkollës së vjetër, të bazuar në drejtimin politik dhe ideologjik dhe në autorizmin absolut gati totalitarist të drejtuesve të saj. Në shkollën tonë të re, të demokratizuar në të gjithë hallkat dhe aksesoret e saj duket se gjërat kanë ndryshuar. Kanë ndryshuar doemos dhe raportet midis aktorëve dhe faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm që lidhen me të. Megjithatë, duket se mbarëvajtja e punëve të shkollës është e lidhur me punën dhe veprimtarinë e një figure kryesore drejtuese, që ka përgjegjësinë e drejtimit ...

10

Prof. Kristo Frashri – Dukagjinët futen në zotërim malet në anën e djathtë të Drinit!

Sipas prof. Kristo Frashri, Dukagjinët futen në zotërim malet në krahun e djathtë të Drinit (Historia e e Skënderbeut fq. 102-103-104). Zotërimi i Dukagjinëve, dikur i papërfillur, tani në vitet '20 të shek.ullit XV ishte në fuqizim të vazhdueshëm në Shqipërinë Veriore. Disa historianë pretendojnë se ata ishin fisnikë me origjinë shekullore, por argumentet nuk janë bindëse. Fillimet e familjes së Dukagjinëve janë shumë të ngjashme me ato të shumicës së familjeve të tjera fisnikërore shqiptare. Ato duhen kërkuar në viset e thella malore, ku krerët lokalë me përkrahjen e bashkësive të lira malësore u rezistuan prirjeve feudale që vinin nga bregdeti, duke u bërë vetë krerë feudale patriarkale të fuqishëm, aq të fuqishëm sa filluan ta shtrinin sundimin e tyre drejt Perëndimit për të dalë, deri sa dolën, në bregdet. Ka të ngjarë që Dukagjinët ta kenë origjinën nga fshati Dukagjin, që ndodhet në Verilindje të krahinës së Matit, nën këmbët e malit të Dejës, në afërsi të krahinës së Mirditës – ashtu si Dushmanët nga fshati Dushman i Dukagjinit të sotëm, Spanët nga një fshat i Pultit malor, Gropat nga fshati Gropë i krahinës së Zerqanit, Muzakët nga fshati i thellë Zërec i Oparit, kurse Kastriotët, sikurse do të shohim, nga fshati Sinë i krahinës malore të Qidhënës në Dibrën e Poshtme. Në kohën e sundimit anzhuin, Mirdita ose Fanti, si quhej në atë kohë, ndodhej nën sundimin e tyre. Malësinë fqinje të Lezhës e kishin në dorë bujarët që mbanin emrin Blinishti, të cilët fituan një pozitë politike, shoqërore më të lartë se atë të Dukagjinëve (njëri prej tyre arriti të bëhet më 1304 mareshal i mbretit anzhuin në Shqipëri, Guillelmus, marescalcus Alba-niae). Me kohë, Blinishtët dolën ngadalë, jashtë jetës së politikës shqiptare, kurse trevën e tyre, Malësinë e Lezhës, e shtinë në dorë Dukagjinët, madje edhe vetë qytetin, duke dalë kështu në bregdet. Por dora-dorës e tyre ata u ndodhën nën manganë e dy forcave armiqësore – venedikasve dhe osmanëve, të cilët nuk do t'u ndaheshin bujarëve Dukagjinë për

gati njëqind vjet. Më 1387, kreu i familjes dinastike, Lekë Dukagjini (Leka III), në emër të vëllait të tij, Palit (od Leke Dukagjin i Pavla bratamu), u jep raguzianëve, me një akt të posaçëm, leje të qarkullojnë lirshëm në territoret e tij, pa pasur frikë nga osmanët, mbasi ai kishte lidhur paqe me ata, me kusht që të paguanin po ato



detyrime që ata paguanin më parë.

Në vitin 1393, pasardhësit e tij u detyruan t'ia lëshonin Lezhën (qytetin) Republikës së Venedikut, kundrejt një provizionit të përvitshëm. Pastaj, duke përfutur nga dobësimi i kundërshtarëve të tyre, Dukagjinët përfshinë nën zotërimin e tyre

viset malore, që shtrihen në lindje të lumit Drin dhe që sot bëjnë pjesë në rrethin e Mirditës, natyrisht pa qytetin e Lezhës. Uniteti midis pinjollëve të familjes së Dukagjinëve, që ekzistonte ende në vitet '20 të shekullit XV, më vonë u prish. Njëri nga anëtarët e familjes, Pal Dukagjini (Pali II), së bashku me të birin, Lekë Dukagjinin

(Leka III), vendosën ta shtrinin sundimin e tyre në të djathtë të lumit Drin – në Pultin e Epërm (Polati Superior), i cili ndodhej në sundimin e Gjergj Dushmanit dhe në Pultin e Poshtëm (Polati Inferior), i cili ndodhej nën sundimin e Pjetër Spanit. Në vitet '40 ata ia arritën qëllimit duke e bërë

kështu zot të asaj krahine të gjerë malore, të cilën osmanët kur e pushtuan i dhanë emrin që mban sot: krahina malore e Dukagjinit, ashtu siç i quajnë, sipas zakonit të tyre, edhe tokat e Gjon Kastriotit (vilayeti Yuvan-ili) ose tokat e Karl Thopisë (vilayeti Karl-ili). Kështu, familja dinastike e Dukagjinëve u nda në dy pjesë, me zotërimet të pavarura nga njëra-tjetra – një palë vazhdoi të sundonte në trevën e mëparshme, siç shkruan Gj. Muzaka “në vendin e quajtur Zadrime me fshatrat e quajtura Fanti dhe me fshatrat e quajtura Mali i Zi” (il paese nomine la Sadrima una con li casali nomine Fanti e li casali nomnati...)

Shënim: Referenca 62: Sipas tregimeve legjendare raguziane, të regjistruara aty nga shekulli XIV, në Kronikën Anonime të Raguzës, fillimet e Dukagjinëve nisin në shekullin e VII, madje në Kronikën e Ragnina-s edhe më herët, në shekullin e VI (Annales Ragusini anonimi, botuar nga Sp. Nodilo 1883). Por këto njoftime (të cilat Ath. Gegaj 1937, f. 72 i konsideron pa të drejtë në konsideratë), nuk përfillen nga historianët kritikë, mbasi konsiderohen pjellë të legjendave ose të fantazive mesjetare. Edhe pohimi tjetër i Ath. Gegajt se Dukagjinët e shekullit XV qenë pasardhës të sundimtarëve të Principatës së Arbërisë, që u formua në fund të shekullit e XII, më saktë, sipas tij, pasardhës të Tanushit (!) dhe të dy djemve të tij, Gjinit dhe Progonit, përveçse ka pasaktësi, mbështetet mbi një supozim dhe jo mbi burime dokumentare (themeluesi i principatës ishte Progoni dhe jo Tanushi, emri i të cilit nuk përmendet gjëkund, kurse Gjini ishte jo vëllai, por biri i Progonit).

Në historiografi duket se ka zënë pikëpamja, se fillimet e tyre duhen kërkuar në periudhën e sundimit të parë anzhuin. Në një akt kancelarie të mbretit Charles d'Angou, lëshuar në vitin 1281, përmendet një dukë Gjini Tanushi shqiptar (dux Tanusius Albanensis; AALb., I, nr. 455), por nëse ky dukë Gjini, nga i cili supozohet të jetë formuar emri i familjes Dukagjin, do të ketë qenë themeluesi i familjes dinastike të Dukagjinëve të shekullit XV.

Epja Zot Nikaj - Merturit

Koncerti që u mbajt në Nikaj-Mërtur ishte si një ushtim i madh në zemër të bjeshkëve tona. Kangë e valle pa mbarim, buzëqeshje, përqafime e njerëz që gëzonin e festonin me njëni-tjetrin, si dikur. Lusim Zotin që kjo festë të bahet traditë e të mbahet çdo vit, gjithmonë e ma madhështore. Këto male, kjo tokë e bekueme prej Zotit na thërret me u bashkue.

Na thërret zani i fëminisë, zani i nanës lokë, kumona e dhenve, gurgullima e lumënjve, stanet e bjeshkëve dhe çdo gur i kësaj treve që mban histori e krenari. Ni-

kaj-Mërturi na thërret për mos me e lanë në harresë, por me u kthye gjithmonë të rrënjët tona, me e dashtë, me e nderue e me ia ruajt traditën brez pas brezi.

Pas koncertit u shtrua një drekë për të gjithë të pranishmit, e organizuar nga organizatorët dhe mundësorët financiar të koncertit. Siç thotë tradita jonë: bukë, kripë e zemër të bardhë.

Faleminderit të gjithëve për mikpritjen, bujarinë dhe respektin që treguan! Faleminderit nga zemra të gjithë pjesëmarrësve që e nderuen këtë koncert, me pra-

ninë e tyne! Faleminderit mundësorëve, kangëtareve, organizatorëve, miqve, shokëve, dashamirëve, vllazënve e motrave të Nikaj-Mërturit, që dhanë kon-

tributin e tyne, për mbarëvajtjen e kësaj feste të paharrueshme! Zoti ju bekoftë ju dhe familjet tueja! Zoti e bekoftë përherë Nikaj-Mërturin! **PLLUM VATNIKAJ**



Lapidari i Nopçes për Dukagjinin!

«Sa për shqiptarët që i quajnë të egër, unë nuk mundem t'i lëvdoj; veç di të them se, për mua, është një komb ndër më simpatikët që njoh. Sepse, në atë vrazhdësi malore, gjejmë tipin më bujar, fisnik, të virtytit e të kombit shqiptar, edhe atëherë kur Turqia i shikonte me sy të shtrembër të gjithë të krishterët, kaurët. Dukagjinasi i ka thënë, me të prurë e me veprat e veta, turkut: "Unë jam shqiptar e zotni në vendin tim, që e kam thirrur dhe do ta thërras Shqipëri."»


Një tokë me histori, por pa kujtesë të dukshme!

Dukagjini banon ndër bjeshkët madhështore të Veriut të Shqipërisë dhe përbën një nga hapësirat më karakteristike të historisë, gjeografisë dhe etnografisë shqiptare. At Zef Harapi e ka cilësuar këtë krahinë si një nga trevat më interesante historikisht dhe më shembullore nga pikëpamja etnografike. Por sot shtrohet një pyetje e thjeshtë: ku është kujtesa e kësaj historie?

Dukagjini dhe Mirdita janë dy prej fortesave tradicionale të besimit shqiptar. Kishat, kryqet dhe vendet e kultit janë pjesë e pandashme e peizazhit dhe e identitetit të këtyre maleve. Le të ngrihen

kryqe dhe të restaurohen faltoret; ato janë pjesë e shpirtit të kësaj toke. Por kujtesa e një populli nuk mund të mbetet vetëm

Sot, në një krahinë që vizitohet nga dhjetëra mijëra njerëz nga Shqipëria dhe bota, mungojnë shenjat që u trego-



në shenjat e besimit. Ajo duhet të jetë e pranishme edhe në muze, lapidare, pllaka përkujtimore, tabela rrugësh dhe botime historike.

jnë vizitorëve se çfarë ka ndodhur këtu, kush kanë qenë njerëzit që kanë lindur e luftuar në këto male dhe cilat ngjarje kanë lënë gjurmë në historinë kombëtare.

Është paradoksale që në shumë vende syri ndesh më lehtë një lapidar të ngritur për viktimat e aksidenteve rrugore sesa një pllakë që përkujton një figurë historike, një ngjarje të rëndësishme apo një dëshmor të kësaj treve.

Sidomos Pulti e Shoshi, me pasurinë e tyre të jashtëzakonshme historike e kulturore, rrezikojnë të paraqiten vetëm si një peizazh i bukur malor.

Por Dukagjini nuk është vetëm natyrë. Është kujtesë, histori, kulturë dhe njerëz.

Kryqet le të shkëlqejnë mbi këto male dhe le ta bekojnë këtë tokë. Por krahas tyre duhet të shkëlqejë edhe kujtesa historike. Një muze i vogël, një lapidar, një pllakë përkujtimore, një tabelë me emrin e një figure apo të një ngjarjeje do t'i jepnin vizitorit mundësinë të shihte përtej bukurisë së peizazhit. Sepse një vend që nuk i tregon historinë e vet, rrezikon të mbetet vetëm një pamje e bukur.

Dukagjini meriton të shihet jo vetëm me sytë e turistit, por edhe me sytë e historisë.

PRELE MILANI

studiuës, poet e publicist

Kryqi që ringjall kujtesën e një fshati të harruar

Në Kodër Shën Gjergj, pranë kishës me të njëjtin emër, tashmë ngrihet një kryq 10 metra i lartë, që shihet nga larg dhe që synon të bëhet simbol i kujtesës, besimit dhe shpresës.

Përrurimi i tij u bë më 17 gusht 2026, në njësinë administrative Shosh, në Bashkinë Shkodër. Kryqi metalik është vendosur mbi një bazament të ndërtuar me kujdes dhe i pajisur me ndriçim, duke e bërë të

dukshëm edhe gjatë natës.

Pas këtij investimi qëndron Arben Mhill Kodra, prej 26 vitesh emigrant në Firence, por që lidhjen me vendlindjen nuk e ka shkëputur kurrë.

Pikërisht kjo kodër mbart një nga historitë më të dhimbshme të zonës. Mes viteve 1946 dhe 1950, dhjetëra burra e gra, kundërshtarë të regjimit diktatorial, u vranë në këtë vend. Sipas kujtimeve të

banorëve, trupat e tyre u hodhën në ujërat e përroit aty pranë.

Kjo histori ka mbetur e gjallë në kujtesën e Arbenit përmes rrëfimeve të prindërve dhe banorëve të vjetër. Për këtë arsye, ai e ktheu në një mision personal vendosjen e një kryqi në këtë kodër, si shenjë përkujtimi për viktimat dhe për të gjitha dhimbjet që ka përjetuar kjo trevë.

Kryqi është vendosur pranë kishës me miratimin e Arqipeshkvisë. Kisha ndodhet ngjitur me shtëpinë e familjes Kodra dhe tashmë të dyja së bashku krijojnë një pikë që mund të marrë një tjetër kuptim për zonën e Dukagjinit.

Sapo kryqi u ngrit dhe dritat u ndezën, ai tërhoqi vëmendjen edhe të vizitorëve të huaj. Pozicioni i tij panoramik e bën të dukshëm nga Qafë-Thorja, Gimaj, Nicaj, Vuksanaj, Breg-Lumi dhe fshatra të tjera përreth.

Por përtej simbolikës, ky vend tregon edhe historinë e një fshati që po shuhet. Dikur këtu jetonin rreth 130 banorë në 17 shtëpi. Sot fshati është pothuajse i braktisur dhe vetëm në periudha të caktuara të vitit rikthehen banorë sezonale.

Shpresa është që, së bashku me restaurimin e kishës, Kodër Shën Gjergji të shndërrohet në një vend pelegrinazhi, duke i dhënë jetë një territori

që rrezikon të mbetet vetëm një kujtim.

Në këtë zonë traditat fetare dhe kulturore vazhdojnë të mbahen gjallë. Këtu kremtohen Nata e Shën Gjergjit, më 23 prill, si dhe Shqyrku i Shoshit, më 13 korrik.

Kryqi i ri tashmë është bërë pjesë e panoramës së krahinës së Shoshit. Por mbi të gjitha, ai është një mesazh: që historia të mos harrohet, vendlindja të mos braktiset dhe kujtesa e atyre që humbën jetën të mbetet e gjallë brez pas brezi.



Arqipeshkvi i Dioqezës Shkodër - Pult, Imzo Giovanni Peragine

Kreshta e përgjakur e Sukës së Mkushit – kujtesa, që nuk vdes

Kelmend – 20 gusht 2026

Në Gropat e Selcës, aty ku historia duket sikur ka mbetur e gdhendur në gur, u përkujtua një nga betejat më të përgjakshme të Kelmendit dhe të Kryengritjes së Malësisë së Madhe të vitit 1911.

Bëhet fjalë për Betejën e Sukës së Mkushit, të zhvilluar më 25 prill 1911, kur forcat osmane, në përpjekje për të nënshtruar Malësinë, u përballën me qëndresën e vendosur të malësorëve.

Në kuadër të fushatës ushtarake të Perandorisë Osmane kundër Malësisë së Madhe, ushtria osmane, e mbështetur edhe nga artileria, sulmoi pozicionet strategjike të Kelmendit. Në Sukën e Mkushit, rreth një mijë luftëtarë kelmendas, nën kryeparinë e Luç Mark Gjeloshit, u përballën me një forcë shumë më të madhe armike.

Për më shumë se gjashtë orë, kreshta u shndërrua në një fushë beteje. Burimet historike dëshmojnë për humbje të mëdha të forcave osmane, me mbi 150 ushtarë të vrarë e të plagosur.

Edhe pse Suka e Mkushit ra, qëndresa e malësorëve mbeti një simbol i trimërisë dhe i sakrificës për liri. Veçanërisht e lavdishme ishte qëndresa e seljanëve, shumë prej të cilëve dhanë jetën në mbrojtje të trojeve të tyre.

Sot, më shumë se një shekull më vonë, emrat e tyre u rikthyen në kujtesën e brezave.

Në memorial janë evidentuar dëshmorët e Kelmendit: Prekë Mark Rudi, Nikë Marash Ujka, Mirash Shyta-Bujaj, Gjekkë Prekë Tinaj, Zef Prekë Tinaj, Voc Gjoni, Pjetër Gjoni Rapuka, Kolec Luku, Gjoni Marash Keku, Dakë Nikë Bogjani,



Kole Toma dhe Kole Leke Bori, i cili ra dëshmor në vitin 1912 në Breg të Matës.

Memoriali, i vendosur buzë rrugës në Gropat e Selcës, është një tjetër dëshmi se historia e Malësisë nuk duhet të mbetet vetëm në libra.

Ai është ngritur falë kontributit të familjes Tinaj, konkretisht të avokatit Ervin Tinajt, emigrant në Michigan të Shteteve të Bashkuara, i cili u largua nga vendlindja, Vermoshi, që në moshën tetëvjeçare, por që, pavarësisht largësisë,

nuk e harroi vendin e origjinës.

Në ceremoninë përkujtimore morën pjesë banorë të zonës, deputeti Bujar Rexha, administratorja Florida Peraj, profesorë e studiues, mes tyre Elena Kocaqi, si dhe të ftuar nga trevat shqiptare, përfshirë Rozhajën, Plavën e Gucinë.

Pranë memorialit është ndërtuar edhe një çezmë. Kështu, udhëtari që kalon në këto anë jo vetëm mund të freskohet, por edhe të ndalet për pak çaste për të njohur historinë e atyre që ranë për lirinë. Sepse



Dom Nike Ukgjini, studies



Rita Shkurtaj, kryetare e Shoqates "Xhubleta e Alpeve Shqiptare"

historia nuk jeton vetëm në dokumente.

Ajo jeton në emra, në gurë, në kujtesën e familjeve dhe në rrugët ku kalojnë brezat.

Dhe kreshta e Sukës së Mkushit, e përgjakur më 25 prill 1911, vazhdon të dëshmojë për trimërinë e malësorëve që zgjodhën të luftojnë për liri, edhe përballë një armiku shumë më të madh.

Kozeta Bruçi

*** Poezi nga AGIM DESKU ***

KUJT T'IA RUAJ PUTHJEN

Pas dy mijë vitesh ferri
mbrëmë të takova Hënë
errësirën ç'ma trete diku larg.

Sytë e mi në stuhi nuk panë
dhe desha të të fal një puthje
të jetoj edhe dy mijë vite tjera.

Besoni, fjalën ia kam dhënë ëndrrës
se puthjen do t'ia ruaj veç zemrës.

NË SYTË E SAJ

Në sytë e saj ndodh të jetojnë
sy të çmendur apokalipsash
në zemër të Evropës kanë hyrë ufot
janë barrikadue, në "luftëtarë" të djallit.

E di veç toka se sa peshojnë rëndë.
Mjerisht kështu ishte dikur
kur vdiq zoti im
edhe pse i thurën lavdi Gjergjit

Tani sy e vesh jemi bërë,
më vjen ta thej ekranin

i tejkaloj lajmet për luftën
por ato nuk zhdukën

Pastaj nga sytë e mi rrjedhin
pika lot dhembjesh
e di që s'kanë fuqi shërimi,
rikujtojnë jetën time dikur në ferr.

Tregojnë dhembëshuri për popujt e robëruar
në sytë e saj të vrarë është edhe emri im.

HESHTJE

Dikur më duhej të jetoja
në heshtje.
Si rebelian i heshtur,
herë mbetesha dhembje e krisur,
çdo herë mëkatar i pafajësisë sime.

Heshta dje.
Në qerpikët e syve tuaj
takova një lumë ëndrrash.
Të barabartë me Titanikun
i bashkuam plagët me të detit.

Sot sërish fjala heshti

u mbush me dhembjet e luleve
sa dëshiroja t'i shëroj plagët
e njeriut fatkeq,
t'i këndoj hymne luftëtarëve .

Nesër a do të heshtë
sikur dje dhe sot
le ta thonë kohërat
që vrasin heshtjen.

TË GJITHË KANË NGA NJË FLAKË

Të gjithë ecin nëpër një flakë zjarri
sikur jetojnë në llavën e çmendurisë së Etnes
veç unë ju mbeta borxh etjes së luleve
t'i ujiti pak para se të mbytej Titaniku.

Sot jam zënë me paburrninë e fjalës
kur asnjëherë në të njëjtin njeri nuk rri
ka humbur edhe tek unë vendin që kishte
mbretëreshë ma të dashur kurrë s'kam pasur.

Tani kam mbetur duke kërkuar flakën e diellit
të shoh ma mirë apo të digjem krejt njëjtë është
të di se dikush jeton me flakën e zjarrit që s'urren
e unë jetoj dhe vdes peng i fjalës që shëron dhembjet.

Rreze Bjeshkës së Shkëlzenit!

Më 6 gusht 2026, u mbajt me një sukses të dëshmuar “Festa e Gashit të Gurit”, e cila përmbylli stinën e një serie manifestimesh që u mbajtën si asnjëherë tjetër më parë, këtë vit në Malësinë e Gjakovës -Tropojë.

Është për tu përmendur se në mbarëvajtjen e kësaj veprimtarie, kanë ndikuar maksimalisht, patjetër grupi organizator, pa të cilin nuk mund të ishte realizuar ai manifestim.

E po ashtu, sikurse u ligjëruan para pjesëmarrësve edhe mbështetja e gjerë me mundësorët nga Gazhjanët ngado që janë, por edhe klima e festive që ka përshkuar këtë vit mbarë Malësinë e Gjakovës-Tropojë. Megjithatë, faktor me rendësi ka qenë edhe mbështetjet si asnjëherë tjetër më parë, që pushteti vendor u ka bërë këtë vit këtyre organizimeve, jo vetëm përmes sigurimit të infrastrukturës së përgatitjes së këtyre veprimtarive, por edhe pjesëmarrja e personelit të Bashkisë Tropojë dhe prezenca e Kryetarit të saj z. Rexhë Byberi.

Por binte dukshëm në sy se përveçse gazhjanve, që ishim më një pjesëmarrje të lavdërueshme në këtë festë, e cila organizohej për herë të parë në atë krahinë, atë e begatuan më pjesëmarrjen e tyre, edhe shumë miq, dashamir nga krahinat e tjera të Malësisë së Gjakovës-Tropojë, por edhe vëllezërit tanë nga Kosova dhe viset e tjera shqiptare të Gadishullit ILIRIK e diaspora. Kështu, që ajo ngjarje manifesteve mbetet për tu shënuar si një ngjarje, e cila arriti një sukses të plotë në realizimin e misionit të saj të përcaktuar nga organizatorët. Kjo arritje e suksesshme duhet trashëguar dhe pasuar nder vite, duke ditur për të nxjerr mësimet e duhura nga ato sa nuk arritën në pritshmërinë e duhur sikurse i ndodh çdokujt dhe përherë, apo edhe ndonjë gabim i mundshëm, e të tjera.

Në këto raste sikurse edhe për rastin në fjalë, shihet e përgjithshmja, e cila ishte shumë e mirë, dhe nga çdonjëri, që është me pak ngushtësi nuk merren në konsideratë detajet, sepse këtyre or-

ganizimeve duhet që tu shërbejnë çdonjëri pjesëmarrës, ashtu sikurse të jetë në shtëpinë e tij, e të tjera.

Pjesëmarrja në Festën e Gashit të Gurit, e cila u mbajt me datën 06.08.2026, rrëzë Bjeshkës së Shkëlzenit, kishte disa motive të përligjura, për pjesëmarrjen time në atë festë.

E para dhe kryesorja ashtu sikurse kemi vepruar në të gjitha organizimet, që janë mbajtur në krahina dhe zona të ndryshme të Malësisë së Gjakovës-Tropojë, jo se ato nuk do ishin berë dhe nuk bëhen pa pjesëmarrjen tonë, por atë e kemi konsideruar dhe e konsiderojmë si një mbështetje morale, pasi ja kemi borxh njeri-tjetrit për të ju gjen- dur pranë në ditë shqetësimi dhe gëzimi sikurse po bëhet tradite e mirë mbajtja në Malësinë e Gjakovës e këtyre festave, dhe këtë vite kanë qenë më mirë se asnjëherë tjetër.

Njëkohësisht kurdoherë të shërbejmë më shembullin tonë, e te stimulojmë veprime përafruese, nxitëse, mbështetëse, bashkërenduese e bashkëpunuese, dhe prej kohësh kemi synuar dhe synojmë që Malësia e Gjakovës të kthehet në harmoni e saj tradicionale dhe të rritet tek çdonjëri dashuria për vendlindjen.

Kurse e veçanta, për rastin në fjalë ndryshe nga të gjitha manifestimet e tjera, që janë mbajtur në malësinë e Gjakovës-Tropojë, këtë radhë shkoja në Gash, tek dajat e mi dhe isha nip nder dajë, kënaqësia më e madhe për ata që e kanë shijuar kohen tradicionale të shkuarjes dhe ndenjës tek dajat. Por, për të qeni i drejtë, njëfarë borxhi ja kisha edhe vet Can Tahirit, i cili herë pas herë ka kontribuar në disa nga të shumtat veprimtari, që ka mbajtur Shoqata Mbarëkombëtare “Bytyçi”, Tiranë Prizren në këto 23 vite veprimtarie, e të tjera. Ama këtë radhë, vetë ai i ka mbetur borxhe pa pas nevojë e tradicionalisht më pa të drejtë, Krahinës së Bytyçit e të Berishës, sepse: Përkundër traditës tone të shkëlqyer, që ka pas e ka Malësia e Gjakovës-Tropojë, gjithmonë e jetë në shtëpinë e vetë e jo vetëm, që miqtë

i respekton kudo që të jenë ata, si: Në “Oden e Burrave”, në “Kuvendë” të ndryshme, se pasi duke e prezantuar pjesëmarrjen e tyre, e më pas jo pa kortezi mirësjellje, duke i lejuar të përshëndesin, së paku një moment sado të vogël, e jo sikurse ndodhi me këtë rast, që përgjatë “mono e dialogëve të stërzgjatura” përgjatë gjithë asaj veprimtarie nuk u gjet mundësia, që asaj veprimtarie ti vihej “Kurora e mikpritjes”. Ndonëse përgjatë gjithë atyre prezantimeve “nuk u kujtuat” ndonjëherë për të lenë pak minuta në atë funksion! Fare mirë këtë ditë, aty mundej që të përshëndeste Administratori i Njësisë Administrative Bytyç-Berishë, i cili ishte prezentë dhe me “një gurë vrisnit” dy zogj. Po ashtu njëherë ajo veprimtari ishte vendi më i përshtatshëm ku të përshëndesnin shkurt edhe disa nga Kryetarët e Shoqatave të reja që kanë nisur punën e tyre shkëlqyeshëm në disa krahina të Tropojës, të cilat edhe nëse nuk do dëshironin, që të mos i shijonin ushqimet e shkëlqyera tradicionale, që kishin përgatitur Gashjanet, të cilët aty nuk kishin ardhur nga ana e anës për një gjë të tillë, por gjithsecili e ka pas në vetvete një “mision”, të mirë. A që më tepër, shoqatat prezentë, më ç raste përshëndetjet nga ato, se paku evidentojë prania e tyre,

përcillnin mesazhet inkurajuese, rritej fryma e bashkëpunimit, por edhe forca gjeneruese e gjithsecilës shoqatë në bashkëpunim me të tjerat, e të tjera.

Bëjmë më dijeni se kanë qenë disa shoqata të kësaj malësie, të cilat e kanë nënshkruar një memorandum bashkëpunimi, ku do të shtohen edhe të gjitha shoqatat e reja, të cilat përkundër frymës përçarës dhe ndarëse, që ka përçarur në këto 26 vite, “stofit i vjetër”, i endur në katakombet e sistemit të vjetër monist, ato do të bashkëpunojnë dhe respektojnë njëra tjetrën.

Prandaj këshillojmë se çdonjëri, që ndërmerr sipërmarrje me karakter shoqërorë, nuk duhet që të kultivojnë ndjenjat sektare, egoist, karrieriste, përkundër bashkëpunimit vëllazëror, gjë për të cilën ka pas dhe ka përvojë të pasur pozitive në Malësia e Gjakovës-Tropojë.

Së bashku si vëllezër dhe motra se bashku në takime të tjera të hareshme.

Për të mira në Gashin e Gurit gjithmonë e jete e po ashtu në çdo vend të Malësisë së Gjakovës-Tropojë.

**Më përkushtim
nga nipi i Gashit të Gurit,
AGRON ISA GJEDIA**



Kardinali Ernest Troshani, ish-burgu i Spaçit, të persekutuarit e komunizmit dhe Zoti Trump



Nga Qamil Gjyzezi

Para disa ditësh u zhvillua në oborrin e burgut të Spaçit një meshë e mbajtur nga Kardinal Ernest Troshani. Akuza e përpiluar në zyrat e sigurimit të shtetit e arrestimit ishte se ai kishte kremtuar një Meshë të Shenjtë për shpirtin e Presidentit të ndërë amerikan John Fitzgerald Kennedy. Ish-burgu i Spaçit në Mirditë u kthye të premten në një vend pelegrinazhi dhe kujtese. Pas dekadash, në vendin ku vuajti 12 vite burg gjatë regjimit komunist, u rikthye eminenca e tij Kardinal Ernest Simoni Troshani. Me të mbërritur atje, ai vizitoi ambientet ku ishte mbajtur i burgosur dhe u ndal pranë fotografive të ish-bashkëvujtësve, duke kujtuar vitet e persekutimit dhe sakrificën e qindra të dënuarve politikë.

Më pas, Kardinali kremtoi Meshën e Shenjtë në oborrin e ish-burgut, në prani të ish-të përndjekurve politikë, besimtarëve të shumtë, përfaqësuesve të komuniteteve fetare, dhe politikës. Në mesazhin e tij, ai rikujtoi momentin e arrestimit e dënimit si dhe u bëri thirrje shqiptarëve të jetojnë me besim, të jenë më pranë Zotit dhe ta duan njëri-tjetrin. “Jeni bijtë e të madhit Zot, të duani njëri-tjetrin, atdheun, me mbrojt të vërtetën. Falënderoj Zotin që na ka bashkuar, njerëzit që me admirim me kanë pritur”, thotë ai.

Teksa e konsideruan Spaçin një simbol të qëndresës komuniste, përfaqësuesit e ish-të përndjekurve politikë, pushtetit vendor dhe dioqezës së Rrëshenit kërkuar më shumë vëmendje nga për ruajtjen e ish-burgut të Spaçit, i cili prej vitesh vijon të degradohet. “Thirrja ime është për qeverinë shqiptare. Ky sit nuk duhet të shkatërrohet. Po u shkatërrua brezat e rinj do të thonë s’ka ndodhur gjë. Kjo do ishte fatkeqësia më e madhe, sepse ajo që harrohet, përsëritet”, tha Dom Gjergj Meta.

Në shenjë mirënjohjeje për jetën e tij të përkushtuar dhe dëshminë e besimit përballë persekutimit, Kardinalit 98-vjeçar iu dorëzua një certifikatë mirënjohjeje dhe një dhuratë simbolike me emblemën e Spaçit. Në këtë ditë nuk mungoi as mesazhi i Atit të Shenjtë, Papa Leone XIV, i cili u lexua gjatë ceremonisë. Mbas meshës së shenjtë të Kardinalit Ernest Troshani në ish-burgun politik të Spaçit luajta në Trombë pjesën ‘Panis Angelicus’ një meditim artistik, në “Dhomën e Maskave”. Aty Arneni i “Tek Bunkeri” ka bërë një mrekulli muzeale përmes regjistrimit të rrëfimeve në kufje të ish të dënuarve politik në këtë burg minierë dhe zhvillova një intervistë me gazetarin Gjergj Marku.



E ardhmja e ish-të përndjekurve politikë dhe integrimi në B.E.

Përndjekja politike nuk është vetëm një ngjarje historike. Ajo mbetet një shenjë kolektive e kujtesës që shoqëria duhet ta interpretojë dhe ta përpunojë. Integrimi evropian e vendos dinjitetin njerëzor, të drejtat dhe shtetin e së drejtës në qendër. Kjo e bën trajtimin e ish-të përndjekurve një simbol të pjekurisë demokratike. Në një perspektivë të re, ish-i përndjekuri nuk duhet të mbetet vetëm një figurë e vuajtjes, por të shihet si qytetar me të drejta, kujtesë dhe kontribut në shoqëri. Integrimi në BE nuk kërkon harrimin e së kaluarës.

Përkundrazi, kujtesa historike mund të shndërrohet në një element të identitetit demokratik shqiptar. Pajtimi nuk do të thotë fshirje e historisë. Pajtimi do të thotë kalim nga konflikti i kujtesave drejt një kuptimi të përbashkët të së shkuarës. E ardhmja duhet të jetë edukimi i brezave

të rinj me historinë, në mënyrë që diktatura të mos mbetet vetëm një kapitull i harruar, por një shenjë paralajmëruese kundër përsëritjes së saj.

Bashkimi European mund të shihet si një shenjë e një rendi të ri politik dhe kulturor, ku individi, liria dhe dinjiteti kanë përparësi ndaj ideologjisë. Si përfundim e ardhmja e ish-të përndjekurve politikë duhet të kalojë nga kujtesa e dhimbjes të dinjitetit, nga përndjekja të integrimi dhe nga viktima të qytetari aktiv evropian. Kryesorja është që integrimi evropian të mos jetë vetëm ekonomik e politik, por edhe një proces i drejtësisë së kujtesës.

Presidenti Trump paralajmëron një ringjallje të “kërcënimit komunist” në SH. B. A.

Në kontekstin e këtyre ngjarjeve, po citoj edhe deklaratat e Presidentit Donald Trump për rrezikun e ringjalljes së komunizmit në SH.B.A. Gjatë fjalimit për

250-vjetorin e pavarësisë së SHBA-së në Uashington, presidenti Donald Trump paralajmëroi për një ringjallje të “kërcënimit komunist” në vend. Ai u shpreh se komunizmi është armik i lirisë dhe Kushtetutës, por theksoi se Amerika nuk do të jetë kurrë një vend komunist. Nëse e analizojmë deklaratën e Donald Trump për komunizmin nga një këndvështrim semiotik-politik, mund ta lexojmë kështu.

Në diskursin e Trump-it, fjala komunizëm nuk funksionon vetëm si term historik, por si një shenjë negative, që simbolizon kufizimin e lirisë dhe kontrollin e shtetit. Komunizmi ndërtohet në kontrast me lirinë. E kaluara përdoret si argument i së tashmes. Historia e komunizmit përdoret si kujtesë politike, për të paralajmëruar shoqërinë ndaj ideologjive që perceptohen si kërcënim për sistemin demokratik. Diskursi krijon një ndarje simbolike midis “neve”, që përfaqëson lirinë dhe demokracinë, dhe “atyre”, që përfaqësojnë ideologjinë komuniste.

Në kuptimin semiotik, komunizmi mund të shndërrohet nga një koncept historik në një mit politik, ku një fjalë e vetme mbart një kompleks të tërë emocionesh: frikë, kujtesë, konflikt dhe kundërshtim. Përdorimi i kësaj shenje ka edhe funksion mobilizues. Ajo synon të krijojë identifikim emocional të publiku dhe të forcojë mbështetjen për një vizion të caktuar politik.

Për shqiptarët që kanë përjetuar diktaturën, fjala komunizëm ka një signifikat historik shumë konkret: përndjekje, burgje, internime dhe kufizim të lirisë. Prandaj, deklarata të tilla mund të marrin një rezonancë të veçantë në shoqërinë shqiptare. Si përfundim, deklarata e Zotit Trump për komunizmin mund të lexohet si një strategji e shenjave politike, ku komunizmi shërben si simbol i asaj që duhet kundërshtuar, ndërsa liria dhe demokracia si simbole të asaj që duhet mbrojtur.



Poetika e pyjeve në një Antologji

Një botim i ri me poezi për pyjet, drurët pyjor, natyrën në përgjithësi tashmë është tek lexuesit. Sipas autorit botimi është për një masë të madhe lexuesish, nga 180 muaj deri 1000 muajsh. Antologji poetike “TRI DËSHIRAT E PYLLIT” e përgatitur dhe botuar nga inxhinieri i pyjeve Gjon Fierza, është libri i dymbëdhjetë i botuar prej tij me tematikë: për pyjet, kullotat, zonat e mbrojtura, e të tjera.

Libri ka në përmbajtje rreth 270 poezi nga 200 autorë. Ky botim ka si qëllim që të përçojë te lexuesit kryesisht tek të rinjtë, nxënës apo studentët ato vlera që ka natyra, vendlindja, pyjet dhe drurët në trojet mbarëshqiptare të shprehura nëpërmjet poezisë. Është koha, sot më shumë se kurrë, kërkohet vëmendje e shoqërisë, strukturave shtetërore në tërësi, për të mbrojtur, drurët dhe pyjet, natyrën dhe mjedisin në tërësi. Në përmbajtje të librit ka dhe poezi që përshkruajnë një shqetësim apo një dëmtim të vlera të natyrës dhe të mjedisit në përgjithësi.

Duke ju referuar përmbajtjes së antologjisë dhe hyrjes së bërë nga autori mund të nënvizojmë disa përfundime të rëndësishme: nga i ka lindur ideja botuesit dhe cilat kanë qënë motivet për këtë botim i pari me këtë tematikë deri sot. Pyjet janë ndër burimet natyrore me një rëndësi të veçantë në jetën e njerëzimit, si faktori kryesor që ndikon në mbrojtjen e planetit nga ndotja dhe ndryshimet klimatike. Pyjet janë burim i jetës në tokë dhe i njerëzve që jetojnë në të. Ato tri dëshira që ka pylli, njeriu lehtë mund dhe duhet t'i plotësojë. Diku thuhet: “Pylli mund ti qëndrojë çdo fuqie të natyrës. Ai i pafuqishëm është vetëm përballë një armiku, ky është njeriu”. Sot kërkohet një punë e madhe edukuese dhe informuese që pyjet dhe natyrën në tërësi, t'i njohim, t'i mbrojmë dhe t'i shtojmë ato. Njeriu, nga armik i pyllit duhet të kthehet një mik i atij. Planeti me njerëzit, pa pyjet nuk mund të jetojnë. Pyllin me drurët dhe banorët e tij, malet dhe fushat, vendlindjen duhet ti duam, të mos i braktisim dhe kjo dashuri duhet vazhdojë me përkujdesje dhe mirëmbajtje të tyre.

Njeriu dhe poezia kanë një lidhje të thellë dhe të hershme, e cila buron nga nevoja e tij për të shprehur ndjenjat, mendimet dhe përvojat jetësore. Poezia është një formë arti që ka shoqëruar njeriun që nga lashtësia, duke i shërbyer si një mënyrë për të komunikuar me botën, për të reflektuar mbi ekzistencën dhe për të shprehur bukurinë apo dhimbjen e jetës. Nëpërmjet poezisë, njeriu ka përjetësuar dashurinë, natyrën, historinë, filozofinë dhe shpirtin e kohës në të cilën ka jetuar. Ajo është një pasqyrë e ndjenjave më të thella njerëzore dhe një mjet për të kapërcyer kufijtë e zakonshëm të gjuhës së përditshme.

Poezia ka fuqinë të prekë zemrat e njerëzve, të frymëzojë dhe të ngjallë emocione të fuqishme. Ajo është gjithashtu një formë e lirisë shpirtërore, ku njeriu mund

të shprehë mendime të thella dhe të sfidojë normat e shoqërisë. Në vargjet poetike, ndjenjat e gëzimit, trishtimit, shpresës dhe ëndrrave bashkohen në një harmoni që e bën poezinë një trashëgimi të çmuar të njerëzimit. “Pylli” dhe poezia kanë një lidhje të ngushtë, pasi pylli shpesh është një motiv i fuqishëm në letërsi dhe poezi.

Pranverën, Pyllin dhe Poezinë, është një datë që i bashkon dhe ju jep një kuptim të gjerë. **Është 21 Marsi- dita e Pranverës, - dita botërore e Pyjeve dhe dita botërore e Poezisë.** Është një përkese e bukur kjo datë me këto tri ditë të shënuara që lidhën shumë me njëri tjetrën. Antologjia poetike që ju keni në duar, është një përpjekje për të përmbledhur ato poezi që janë shkruar për pyjet, drurët dhe banorët e pyjeve, për natyrën me male, lumenj e kodra; për vendlindjet, për jetën në vendet ku flitet shqip. Titulli është përzgjedhur nga një prej poezive në këtë botim, që ka qënë dhe motivi për të bërë përzgjedhjen e këtyre poezive. “Tri

tokat e shqiptarëve: nga Shqipëria, nga Kosova, nga Presheva e Maqedonia e Veriut, nga Çamëria e Mali i Zi dhe nga Kalabria. Disa nga autorët prej shumë vitesh jetojnë e punojnë larg atdheut por përseri ata shkruajnë për natyrën, për pyjet dhe jetën në Shqipëri. Autorët e poezive, janë poet të traditës por dhe të ditëve të sotme, janë emra të njohur që studiohen në letërsi, por dhe autorë më pak të njohur por që kanë shkruar për tematikën e përzgjedhur. Poezitë në këtë antologji, janë nga shkruar dhe nga shumë poet të moshave të reja.


Periodha gati 50 vjeçare e inxhinierit Gjon Fierza e **lidhur** me pyjet në veçanti dhe me natyrën në përgjithësi kanë ardhur duke e formësuar nga dijet dhe kultura si nxënës dhe student për pyjet, për të fituar një profesion. Periodha e gjatë në vende dhe detyra të ndryshme të lidhura ngushtësisht me pyjet dhe me njerëzit ajo ju shndërrua në pasion. Gjoni nënvizon faktin **”Të punosh për pyjet dhe natyrën,**

kësaj antologjie.

Si një përpjekje e parë për një botim të tillë, natyrisht që mund të vihen re edhe të meta, mangësi apo boshllëqe. Një vepër e parë e këtij lloji nuk mund dhe nuk duhet të pretendojë përsosmërinë. Përkundrazi, ajo duhet të shihet si fillimi i një rruge. Mund të ishin përfshirë edhe dhjetëra poezi të tjera të qenësishme, të cilat do ta plotësonin më tej tematikën e kësaj antologjie. Po kështu, mund të ishin përfshirë edhe shumë poetë të tjerë të merituar, të cilët në krijimtarinë e tyre i janë kushtuar natyrës, pyjeve, maleve, fushave, lumenjve, pemëve dhe bukurive të vendit tonë.

Por pikërisht këtu qëndron edhe një nga bukuritë e kësaj nisme: ajo nuk duhet konsideruar si një vepër e mbyllur, por si një fillim.

Le ta konsiderojmë këtë antologji si **vëllimin e parë të një kolane** që mund të pasurohet ndër vite me vëllime të tjera. Poetët do të vazhdojnë të shkruajnë. Do



Gjon Fierza, ka lindur 5. 6. 1957 në fshatin Plan, Dukagjin Shkodër. Jeton në Tiranë

-Në periudhën: 1976-1978, teknik pyjesh në Ndërmarrjen Pyjore Shkodër.

-1978-1982, student në Fakultetin e Pyjeve Tiranë.

-1982-1993, inxhinier dhe Kryetar i Degës Teknike në Ndërmarrjen e Përpunimit të Drurit Fushë-Arrëz.

-1993-1998, inxhinier dhe Shefi Seksionit Teknik, në D.S.H.P. Lezhë

-1998-2004, konsulent në tre projekte ndërkombëtare: dy USAID, një i Bankës Botërore

-2004-2006, shef i Seksionit të Silvikuturës në Drejtorinë e

Përgjithshme të Pyjeve, Tiranë

-2006-2010, specialist në Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.

-2010-2014, shef i Seksionit të Menaxhimit dhe Ekstensionit në D.S.H.P. Tiranë

-2014-2020, specialist në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, Tiranë.

-2020-2023, specialist në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve, Tiranë.

-Maj - Dhjetor 2023 Këshilltar i Jashtëm i Ministrisë të Turizmit dhe Mjedisit,

-Në vitin 2024, del në pension.

Ka botuar si autor dhe bashkautorë në fushën e pylltarisë dhe mjedisit:

► *Tri Dëshirat e Pyllit - Antologji Poetike*, 2026

► *Pyjet dhe Sharrat e Pukës në vite* (b.autorë), 2024

► *Burimet natyrore dhe mbarështimi i qëndrueshëm në N.J.A Shëngjin*, 2015

► *Menaxhimi i burimeve natyrore me pjesëmarrje të komunitetit* (b.autorë), 2015

► *Manual "Rritja e aftësive të komunikimit të Shoqatave të pyjeve komunal", 2013*

► *Pyjet dhe Shërbimi pyjor shqiptar në vite* (b.autorë), 2013

► *Libri "Pylli dhe Njeriu" (b.autorë) - 2012*

► *Pëmbledhje Ligjore "Për Pyjet, Kullotat dhe Zonat e Mbrojtura*, 2008

► *Manuali "Për përdorimin e pyjeve dhe kullotave komunale" (b.autorë), 2008*

► *Monografia "Zonat e Mbrojtura, Parqet Kombëtare" në Shqipëri* (b.autorë), 2004

► *Monografia "Prodhimet pyjore jodrusore në Shqipëri" (b.autorë), 2004 ;*

► *Manuali i Kalimit të Pyjeve dhe Kullotave në përdorim të Komunave (b.a), 2000*

Në periudhën 2002-2006, ka qënë kryeredaktor i Buletinit Informativ për Pyjet, organ i Drejtorisë Përgjithëshme Pyjeve dhe Kullotave, Tiranë.

Në periudhën 2006-2010, ka studiuar në Shkollën Pasuniversitare në Fakultetin e Shkencave Pyjore dhe ka marrë titullin "Master Shkencor"

dëshirat e pyllit” është një poezi e shkruar që në vitin 1949 dhe botuar në revistën “Bujku i ri” “Tri dëshirat e pyllit”, është një poezi e shkruar disi ndryshe, është dialog midis pyllit dhe njeriut. Ju do lexoni poezinë dhe do zbuloni tri dëshirat e pyllit që i kërkon t’i plotësohen nga njeriu. Edhe dëshirat e pyllit janë në tri fjalë. Është fakt interesant se ajo poezi është shkruar nga një agronomi i diplomuar jashtë vendit në fillimin e viteve 50 dhe quhet **Ilo Kosta**.

Në këtë antologji poetike, do të gjeni poezi të shkruara nga poetë nga të gjithë

për vijueshmërinë e tyre në shërbim të njerëzimit sot dhe mot, nuk është një profesion që mund të shndërrohet në pasion por duhet konsideruar si mision”.

Të lexosh një poezi për një pyll, për një pemë, për një mal apo për një burim uji do të thotë të shohësh natyrën me një sy tjetër. Ajo nuk mbetet më thjesht një hapësirë fizike. Shndërrohet në kujtim, në emocion, në histori, në vendlindje, në trashëgimi dhe në përgjegjësi. Pikërisht kjo është një nga vlerat më të mëdha të

të shkruajnë për natyrën, për pyjet dhe drurët, për malet dhe fushat, për lumenjtë dhe liqenet, për zogjtë dhe kafshët, për stinët, për vendlindjen dhe për marrëdhënien e njeriut me mjedisin ku jeton. Sa kohë që ekziston natyra dhe sa kohë që ekziston njeriu që e vëren, e përjeton dhe e ndien atë, do të ketë gjithmonë krijime të reja që mund të na japin kënaqësi estetike dhe, mbi të gjitha, mesazhe të rëndësishme.

(vijon në faqen 11)

DR. ZEF ZEFAJ

MJEKU QË U BË INSTITUCION!

MESAZH URIMI, GJINEKOLOGUT TË TALENTUAR,
“MJESHTRIT TË MADH” DR. ZEFAJ, NË 80-VJETORIN E
LINDJES SË TIJ



FRAN GJOKA

Shumë njerëz lënë pas emrin e tyre në dokumente, libra apo fotografi. Ka të tjerë që jetojnë gjatë në kujtesën e njerëzve, sepse veprën e kanë shkruar në jetën e përditshme të një komuniteti. Ata nuk mbahen mend vetëm për atë çfarë kanë bërë, por për atë çfarë kanë qenë. Kësaj kategorie i përket pa dyshim edhe doktori i mirënjohur Zef Zefaj, një nga figurat më të shquara të mjekësisë shqiptare dhe një ndër personalitetet më të respektuara të qytetit të Lezhës.

Nuk është rastësi që Materniteti i Spitalit Rajonal të Lezhës mban sot emrin e tij. Ky nuk është vetëm një vendim administrativ, por shprehja më domethënëse e mirënjohjes së një qyteti ndaj njeriut që për më shumë se katër dekada e shndërroi profesionin në mision dhe shërbimin ndaj jetës në ideal.

Me vendimin nr. 41, datë 23 mars 2018, Këshilli Bashkiak i Lezhës vendosi unanimisht që Shtëpia e Lindjes të mbajë emrin “Dr. Zef Zefaj”, duke vlerësuar kontributin e tij në themelimin dhe konsolidimin e shërbimit obstetrikogjinekologjik, në rritjen e cilësisë së kujdesit ndaj Nënës dhe Fëmijës, në futjen për herë të parë të teknikave të reja mjekësore në Spitalin e Lezhës dhe në ngritjen e standardeve profesionale të këtij shërbimi. Ishte një vendim që nuk nderonte vetëm një mjek, por një epokë të tërë të shëndetësisë lezhjane.

Më 26 korrik 1946, në fshatin Tresh të Lezhës, erdhi në jetë Zef Zefaj. Fëmijëria e tij nuk pati lehtësitë që do të dëshirononte çdo fëmijë. Vetëm katër vjeç mbeti pa të atin, i cili u vra tragjikisht nga bandat kriminale të kohës dhe më pas u shpall Dëshmor i Atdheut. Kjo humbje e hershme la gjurmë në jetën e tij, por nuk e ligështoi karakterin. Përkundrazi, e bëri më të fortë, më të ndjeshëm ndaj dhimbjes njerëzore dhe më të vendosur për t'i shërbyer jetës.

Nga nëna trashëgoi një tjetër pasuri të çmuar. Ajo vinte nga një familje e njohur e Bulgerit të Rubikut, e cila ishte dalluar brez pas brezi për dijet e mjekësisë popullore dhe për gatishmërinë për t'u ardhur në ndihmë njerëzve. Ndoshta pikërisht aty, në atë traditë të heshtur humanizmi, u

mboll fara e thirrjes së tij drejt mjekësisë.

Shkollën fillore, shtatëvjeçaren dhe gjimnazin i kreu në Lezhë, duke qenë pjesë e brezave të parë të gjimnazit “Hydajet Lezha”. U dallua për rezultate të shkëlqyera dhe për një disiplinë shembullore. Që në bankat e shkollës e kishte të qartë rrugën që dëshironte të ndiqte. Ëndrra për t'u bërë mjek nuk ishte një dëshirë kalimtare, por një bindje e hershme që do ta shoqëronte gjatë gjithë jetës.

Në vitin 1964 nisi studimet në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit Shtetëror të Tiranës. Ishin vite kërkuese, por ai i jetoi me përkushtim dhe seriozitet. Përveç studimeve, mori pjesë aktive në rrethet shkencore të fakultetit dhe u dallua për prirjen ndaj kërkimit shkencor. Madje, referoi edhe temën e tij të parë në një sesion kombëtar studentor, një tregues i qartë se për të mjekësia nuk do të ishte vetëm praktikë, por edhe dije e vazhdueshme.

Pas diplomimit në vitin 1969, filloi specializimin në obstetrikë-gjinekologji pranë Maternitetit të Tiranës. Aty u formua profesionalisht nën drejtimin e specialistëve më të mirë të kohës, duke fituar përvojën që do ta vinte më pas në shërbim të vendlindjes.

Kur përfundoi specializimin në fund të vitit 1972 dhe u kthye në Lezhë, përpara kishte një sfidë të jashtëzakonshme. Shërbimi obstetrikogjinekologjik ishte ende në hapat e parë, infrastruktura ishte modeste, ndërsa lindjet në shumë zona të thella vazhdonin të kryheshin në kushte të vështira, shpesh larg çdo sigurie mjekësore. Për shumëkënd kjo do të kishte qenë vetëm një detyrë pune. Për doktor Zef Zefajn ishte misioni i jetës. Ai nuk u mjaftua të punonte brenda mureve të maternitetit. Filloi të ndërtonte një sistem të ri shërbimi, të organizonte ekipet, të rriste nivelin profesional të mamive dhe infermierëve, të vendoste standarde të reja pune dhe, mbi të gjitha, të krijonte besimin se çdo nënë, pavarësisht se ku jetonte, kishte të drejtën të sillte në jetë fëmijën e saj në kushte sa më të sigurta. Që nga ato vite filloi një histori që do të ndryshonte përgjithmonë fytyrën e shërbimit obstetrikogjinekologjik në Lezhë.

Kur mjekësia bëhet mision.

Kur doktori i ri Zef Zefaj mori drejtimin e Shërbimit të Obstetrikë-Gjinekologjisë në Spitalin e Lezhës, nuk kishte përpara një institucion të konsoliduar, por një fushë të gjerë pune që priste të ndërtohej me përkushtim, dije dhe vizion. Ishin vitet kur shërbimi shëndetësor në Shqipëri po përpiquej të shtrihej në çdo cep të vendit, ndërsa në shumë zona lindjet vazhdonin të kryheshin në shtëpi, larg çdo ndihme të specializuar. Për nënat dhe foshnjat, kjo përbente një rrezik të vazhdueshëm.

Dr. Zef Zefaj e kuptoi se mjeku nuk

duhej të priste pacientin; shpesh ishte ai që duhej të shkonte tek pacienti. Kjo filozofi pune u bë boshti i gjithë veprimtarisë së tij profesionale.

Në vitin 1973 ai organizoi për herë të parë shërbimin e pavarur të Obstetrikë-Gjinekologjisë në Spitalin e Lezhës, duke krijuar një strukturë moderne për kohën, me përgjegjësi të qarta, shërbim të pandërprerë dhe një disiplinë profesionale që do të shërbente si model për vitet që do të vinin. Nuk ishte thjesht një ndryshim organizativ, ishte fillimi i një kulture të re pune, ku në qendër vendosej siguria e nënës dhe e fëmijës.

Në pak vite u zgjerua ndjeshëm rrjeti i materniteteve dhe i pikave të lindjes në të gjithë rrethin. Nga tre maternitete që funksiononin më parë, numri i tyre arriti në gjashtëmbëdhjetë, ndërsa personeli obstetrikal u shumëfishua. Ky zhvillim nuk ishte vetëm statistikë, ai nënkuptonte më shumë gra që kishin pranë një mami të kualifikuar, më shumë foshnja që vinin në jetë në kushte të sigurta dhe më shumë familje që fitonin besim te shërbimi shëndetësor.

Por doktor Zefi nuk e shihte mjekësinë si një profesion që mbaronte në pragun e spitalit. Shpesh ai nisej drejt zonave më të largëta malore të Lezhës, Mirditës, Kurbinit, madje edhe të Pukës, për të ndihmuar gra që nuk kishin mundësi të mbërrinin në maternitet. Ishin udhëtime të gjata, të lodhshme dhe shpesh të rrezikshme. Në shi, në borë, në vapë, ditën apo në mesnatë, ai dhe ekipi i tij përshkonin kilometra të tëra në këmbë ose me mjetet e pakta të kohës, sepse përballë tyre nuk ishte vetëm një rast mjekësor, por një jetë që priste të vinte në këtë botë.

Janë rreth njëqind lindje të kryera jashtë ambienteve spitalore, në kushte tepër të vështira, një dëshmi e rrallë e sakrificës dhe e përgjegjësisë profesionale. Për çdo familje që përjetoi ato çaste, prania e doktor Zefit ishte sinonim i shpresës.

Në ato vite, sfidë e madhe ishte edhe vdekshmëria foshnjore. Kur ai mori drejtimin e shërbimit, statistikën ishin shqetësues. Vetëm në vitin 1972 regjistroheshin 44 vdekje foshnjore për çdo një mijë lindje. Ishte një realitet që kërkonte jo vetëm punë të përditshme, por edhe ndryshim të mënyrës së të menduarit.

Së bashku me ekipin e tij, doktor Zef Zefaj ndërtoi një sistem të ri monitorimi të shtatzënive, rriti kontrollin para lindjes, forcoi bashkëpunimin me mamitë dhe përmirësoi ndjekjen e të porsalindurve. Falë këtij organizimi dhe punës së palodhur, raporti i vdekshmërisë foshnjore ra në mënyrë të ndjeshme, duke zbritur nga 44 në vetëm 15 raste për një mijë lindje. Për kohën, ishte një arritje e jashtëzakonshme, që fliste më shumë se çdo dekoratë.

Po aq domethënëse ishte edhe një tjetër sukses. Në maternitetin e Lezhës u arrit të eliminohej vdekshmëria amtare gjatë lindjes, një tregues që, nga viti 1994, mbeti në nivelin zero. Pas këtij rezultati fshiheshin mijëra orë pune, qindra ndërhyrje të vështira, vendime të marra në sekonda dhe një përgjegjësi që nuk njihte pushim.

Mjekësia nuk është vetëm shkencë, ajo është edhe besim. Dhe ky besim fitohet me përkushtim. Pikërisht për këtë arsye, doktor Zef Zefaj u bë shpejt jo vetëm shefi i repartit, por njeriu tek i cili njerëzit drejtoheshin me sigurinë se do të gjenin

zgjidhje, qetësi dhe mbështetje.

Kolegët kujtojnë se ai ishte kërkues para së gjithash me veten. Kërkonte disiplinë, përpikmëri dhe përgatitje profesionale, por po aq dinte të inkurajonte dhe të mbështeste stafin e ri. Për shumë mjekë, mami dhe infermierë që hodhën hapat e parë në maternitetin e Lezhës, doktor Zefi nuk ishte vetëm drejtuesi i repartit, ai ishte mësuesi që u mësoi se mjekësia nuk ushtrohet vetëm me dije, por edhe me ndërgjegje.

Në këtë rrugëtim ai pati përkrah bashkëpunëtorë të përkushtuar, ndër të cilët vend të veçantë zinte i ndjeri doktor Llesh Mataj, drejtues i Shërbimit Pediatrik. Bashkëpunimi ndërmjet tyre krijoi një frymë pune ku interesat e pacientit ishin gjithmonë mbi gjithçka tjetër. Ishte një partneritet profesional që la gjurmë në historinë e spitalit dhe në kujtesën e brezave të mjekëve.

Pak nga pak, materniteti i Lezhës nuk ishte më thjesht një repart spitalor. Ai po shndërrohej në një institucion ku profesionalizmi, humanizmi dhe përgjegjësia ecin krah për krah. Çdo lindje e suksesshme ishte një fitore e heshtur. Çdo fëmijë që qante për herë të parë ishte dëshmia më e bukur e një misioni që vazhdonte çdo ditë, pa bujë, por me përkushtim të pashtershëm. Në ato vite u hodhën themelet e një shërbimi që shumë shpejt do të tërhiqte vëmendjen jo vetëm në Lezhë, por në të gjithë Shqipërinë.

Kur përvoja kthehet në shkollë.

Një mjek i mirë nuk kënaqet kurrë me atë që di. Ai kërkon vazhdimisht të mësojë, të përsoset dhe t'ia kthejë dijen shoqërisë në shërbim konkret. Ky ishte edhe parimi që udhëhoqi gjithë jetën profesionale të doktor Zef Zefajt. Për të, diploma nuk shënonte fundin e të mësuarit, por fillimin e një përgjegjësie të re.

Që në vitet e para të punës, ai e kuptoi se zhvillimi i shërbimit obstetrikogjinekologjik nuk mund të mbështetej vetëm në përvojën praktike. Përparimi kërkonte kërkim shkencor, përditësim të vazhdueshëm dhe guxim për të sjellë risi. Kjo e shtyu të merrte pjesë në sesione shkencore, konferenca dhe botime profesionale, duke u bërë një nga zërat më aktivë të mjekësisë shqiptare në fushën e obstetrikës dhe gjinekologjisë.

Që në vitin 1970, në bashkëpunim me doktor Apollon Gjebrenë, ai botoi studimin e tij të parë në revistën “Shëndetësia Popullore”, një punim që u mirëprit nga komuniteti shkencor. Më pas, gjatë viteve 1973–1990, referoi një numër të madh temash në sesionet shkencore të Spitalit të Lezhës, ndërsa shumë prej tyre u botuan në revistat “Shëndetësia Popullore” dhe “Nëna dhe Fëmija”. Këto nuk ishin thjesht arritje personale; ato pasqyronin përvojën e fituar në terren dhe dëshirën për ta kthyer atë në dije të dobishme për kolegët. Ndërkohë, puna në maternitet nuk reshti asnjë ditë. Përkundrazi, përvoja e përditshme bëhej burimi më i mirë i kërkimit shkencor. Çdo rast i vështirë, çdo ndërhyrje dhe çdo sukses i shërbimit analizoheshin me kujdes, për të nxjerrë mësim dhe për të përmirësuar më tej praktikën mjekësore. Falë këtij vizioni, materniteti i Lezhës filloi të shquhej jo vetëm për rezultatet klinike, por edhe për kulturën profesionale që po ndërtohej

brenda tij.

Në fillim të viteve '90, kur Shqipëria po hynte në një periudhë të re zhvillimi, doktor Zef Zefaj ishte ndër mjekët që kërkuar të sillnin në vend përvojat me bashkëkohore evropiane.

Në vitin 1993 ai u përfshi në një program studimor në Tunizi, ku së bashku me specialistë të tjerë shqiptarë u njoh me metodat moderne të planifikimit familjar. Kjo përvojë u bë një pikënisje e rëndësishme për zbatimin e praktikave të reja edhe në Shqipëri. Po aq i rëndësishëm ishte specializimi në Kantonin Vaud të Zvicrës, organizuar në bashkëpunim me Caritasin Zviceran dhe Ministrinë e Shëndetësisë. Atje ai pati mundësinë të njihje nga afër standardet më të avancuara të kujdesit obstetrikal, të cilat më pas i përshtati me sukses në realitetin shqiptar. Ai u trajnuar gjithashtu në Yverdon të Zvicrës, në Stamboll, në Moskë dhe në qendra të tjera të rëndësishme mjekësore, duke sjellë në Lezhë jo vetëm dije të reja, por edhe një filozofi moderne të trajtimit të nënës dhe të porsalindurit.

Një nga kapitujt më të rëndësishëm të veprimtarisë së tij lidhet me transformimin e maternitetit sipas standardeve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë.

Në mesin e viteve '90, nën drejtimin e doktor Zef Zefajt dhe ekipit të tij, në maternitetin e Lezhës filluan të zbatoheshin praktika krejtësisht të reja për vendin tonë. U vendos që foshnja të qëndronte pranë nënës menjëherë pas lindjes; u inkurajua ushqyerja ekskluzive me gji, u krijuan kushtet që edhe babai të ishte i pranishëm në momentin e lindjes dhe u braktisën gradualisht praktika të vjetruara që nuk i shërbenin më mirëqenies së nënës dhe fëmijës. Sot këto mund të duken të zakonshme. Atëherë ishin risi të guximshme. Falë këtyre ndryshimeve, materniteti i Lezhës fitoi statusin "Spital Mik i Fëmijëve", duke u bërë i pari institucion i këtij lloji në Shqipëri dhe ndër të parët në Evropë që plotësoi standardet ndërkombëtare të këtij programi. Ky ishte një sukses që nuk i përkiste vetëm një spitali. Ishte një sukses i mjekësisë shqiptare. Përvoja e Lezhës u bë model për shumë maternitete të tjera të vendit. Specialistë nga qytete të ndryshme vinin për të parë nga afër mënyrën e organizimit të punës, ndërsa rezultatet e këtij transformimi u prezantuan në konferenca dhe seminare kombëtare e ndërkombëtare.

Në shumë drejtime, materniteti i Lezhës u kthye në një shkollë të vërtetë profesionale.

Për doktor Zef Zefajn, zhvillimi i shërbimit nuk ishte kurrë meritë e një njeriu të vetëm. Ai besonte te forca e ekipit. Prandaj investoi vazhdimisht në përgatitjen e mjekëve të rinj, të mamive dhe të infermierëve, duke krijuar një klimë pune ku profesionalizmi dhe respekti për pacientin ishin parime të panegociueshme. Shumë prej specialistëve që sot ushtrojnë me sukses profesionin në Lezhë dhe më gjerë e kujtojnë atë si mentorin e tyre të parë. Ai nuk impononte autoritetin me zë të lartë, por me shembullin personal. Ishte ndër ata drejtues që më shumë mësonin duke punuar sesa duke urdhëruar. Pikërisht për këtë arsye ndikimi i tij nuk kufizohet vetëm në mijëra pacientët që trajtoi. Ai vazhdon të jetojë edhe në pu-

nën e brezave të mjekëve që formoi, në kulturën profesionale që la pas dhe në standardet që vendosi. Mbase ky është suksesi më i madh i një mjeku: jo vetëm të shpëtojë jetë, por të formojë njerëz që do të vazhdojnë të shpëtojnë jetë edhe pas tij. Në këtë kuptim, doktor Zef Zefaj nuk ndërtoi vetëm një repart. Ai ndërtoi një traditë profesionale që vazhdon të japë fryte edhe sot.

Trashëgimia që nuk njej kohë.

Pak njerëz kanë fatin që puna e tyre të matet jo me vitet e shërbimit, por me jetët që kanë ndihmuar të nisin. Doktor Zef Zefaj është një prej tyre. Për më shumë se katër dekada, ai nuk ishte thjesht një obstetër-gjinekolog i aftë, ai ishte njeriu që ndante me mijëra familje çastin më të bukur dhe më të përgjegjshëm të jetës së tyre. Në sallat e maternitetit të Lezhës, nën

riprodhues në Shqipëri. Në vitin 1995 ai kontribuoi, së bashku me specialistë të tjerë, në hartimin e ligjit "Mbi Abortin", ndërsa për një dekadë drejtoi programet e planifikimit familjar për zonën veriore të vendit. Njëkohësisht, ai vazhdoi të kontribuonte edhe në fushën akademike. Bashkautor i librit "Pyetje dhe Përgjigje në Gjinekologji", si dhe autor i një botimi tjetër mbi problematikat gjinekologjike, ai u përpoq ta shndërronte përvojën e fituar gjatë mijëra ndërhyrjeve klinike në dije të dobishme për brezat e rinj të mjekëve. Në çdo etapë të jetës profesionale ai mbeti besnik një motoje të thjeshtë, por të thellë: "Nga çdo shtatzëni e nisur duhet të lindë një fëmijë i shëndetshëm." Në këtë fjali përmbledhet e gjithë filozofia e tij si mjek. Nuk ishte vetëm një objektiv profesional, ishte një mënyrë të menduari, një etikë pune dhe një premtim ndaj jetës.



Doktori Zef Zefaj, "Mjeshtër i madh", në 80-vjetorin e tij

kujdesin e tij dhe të ekipit që drejtoi me profesionalizëm, erdhën në jetë rreth 43 mijë fëmijë. Pas këtij numri marramendës nuk fshihen vetëm statistika. Fshihen mijëra histori familjesh, mijëra lot gëzimi, mijëra zemra që nisën të rrahin për herë të parë nën kujdesin e një mjeku që e konsideronte çdo lindje si një përgjegjësi të shenjtë. Edhe në vitet më të vështira, kur mungonin mjetet, infrastruktura apo kushtet optimale, ai nuk lejoi kurrë që këto pengesa të bëheshin justifikim për të ulur cilësinë e shërbimit. Përkundrazi, ishte bindur se vlera më e madhe e një mjeku nuk qëndron vetëm te pajisjet moderne, por te ndërgjegjia profesionale, dija dhe përkushtimi. Kjo filozofi pune e shoqëroi deri në ditën e fundit të karrierës së tij aktive.

Veprimtaria e doktor Zef Zefajt nuk mbeti e kufizuar brenda mureve të spitalit. Përvoja e tij profesionale u bë pjesë e zhvillimit të politikave moderne të shëndetit

Shoqëria shqiptare dinte të vlerësonte njerëzit që linin gjurmë.

Për kontributin e tij të jashtëzakonshëm në shërbim të shëndetit të nënës dhe fëmijës, doktor Zef Zefaj u nderua me urdhra e medalje të ndryshme, ndër të cilat spikat Urdhri "Për Shërbime Shëndetësore" i Klasit të Parë. Më pas, Presidenti i Republikës i akordoi titullin e lartë "Mjeshtër i Madh", një vlerësim që u rezervohet personaliteteve me kontribute të veçanta në jetën e vendit. Megjithatë, ndoshta nderimi më i bukur nuk erdhi nga institucionet. Ai erdhi nga qyteti. Vendimi që Materniteti i Spitalit Rajonal të Lezhës të mbajë emrin "Dr. Zef Zefaj" është shumë më tepër sesa një akt administrativ. Është një shenjë mirënjohjeje qytetare, një mënyrë për t'u thënë brezave të ardhshëm se ka njerëz që e meritojnë të kujtohen çdo ditë. Sepse emrat e institucioneve nuk zgjidhen rastësisht. Ata u besohen njerëzve që kanë ditur t'u japin

institucioneve shpirt.

Vlerësimet e kolegëve të tij janë po aq domethënëse sa dekoratat.

Profesorë, drejtues institucionesh dhe mjekë të njohur kanë folur gjithmonë me respekt për profesionalizmin, seriozitetin dhe humanizmin e doktor Zef Zefajt. Ata kanë vlerësuar jo vetëm aftësitë e tij si kirurg dhe obstetër, por edhe cilësitë e tij si drejtues, edukator dhe koleg. Ata e kujtojnë si njeriun që nuk reshti kurrë së mësuarit dhe së mësuarit të tjerët, si drejtuesin që kërkonte disiplinë pa humbur njerëzoren, si mjekun që nuk e ndante profesionin nga përgjegjësia morale. Ky është respekti që nuk fitohet me një vendim apo me një titull. Ai fitohet vetëm me një jetë të jetuar në shërbim të të tjerëve.

Sot, kur doktor Zef Zefaj gëzon vitet e pensionit, ai mbetet po aq i pranishëm në kujtesën e qytetit. Vazhdimisht e kërkojnë mjekët e rinj për konsulta dhe shërbime. Breza të tërë prindërisht, mjekësh dhe infermierësh vazhdojnë ta përmendin me mirënjohje, sepse secili ruan një kujtim që lidhet me emrin e tij: një lindje të vështirë, një këshillë profesionale, një natë pa gjumë në sallën e lindjes apo një fjalë qetësuese në çastet më të vështira. Në një kohë kur shoqëria ka nevojë për modele të vërteta, figura e doktor Zef Zefajt dëshmon se madhështia nuk ndërtohet me bujë, por me punë të përditshme, me përkushtim dhe me ndershmëri. Ai nuk kërkoi kurrë lavdi. Lavdia e gjeti vetë. Jo sepse ishte një mjek i shquar, por sepse ishte një njeri i madh.

Në vend të epilogut

Në historinë e çdo qyteti ka njerëz që bëhen pjesë e identitetit të tij. Ata nuk ndërtojnë vetëm institucione; ndërtojnë besim. Nuk lënë pas vetëm kujtime, lënë shembull. Doktor Zef Zefaj është një prej atyre personaliteteve që i japin kuptim fisnikërisë së profesionit të mjekut. Lezha ka nxjerrë shumë njerëz të nderuar, por pak prej tyre kanë pasur privilegjin të lidhen kaq ngushtë me fillimin e jetës së mijëra qytetarëve të saj. Për këtë arsye, emri i tij është tashmë pjesë e historisë së këtij qyteti dhe e kujtesës së mjekësisë shqiptare.

Ndërsa bashkëshortja e tij, Rexhina, edhe pse ka vite që ka dalë në pension, vazhdon e punon me intensitet në farmacinë e saj private. Një farmacistë e talentuar, me cilësi të vyera e kulturë të lartë. Një nënë, zonjë e shkëlqyer, një bashkëshortë modl, një qytetare me emancipim bashkëkohor, njëkohësisht i urojmë Rexhines 75-vjetorin e saj të lindjes, pleqëri të mbarë dhe e nderuar e krenare për vlerat e saj në fushën e farmaceutikës.

Në përvjetorin e lindjes së tij, nderimi më i bukur nuk është vetëm urimi për shëndet e jetë të gjatë. Është mirënjohja e sinqertë për një jetë të tërë të vënë në shërbim të jetës. Sepse ka emra që shkruhen në gur. Ka emra që shkruhen në libra. Por ka edhe emra që shkruhen në zemrat e njerëzve. Emri i doktor Zef Zefajt është njëri prej tyre i shkruar në zemrat e njerëzve. Unë, si shok dhe mik i tij, i uroj 75-vjetorin e lindjes, shëndet dhe jetë të gjatë bashkëshortore! Kudo ti mbetësh përherë i nderuar e krenar, si një zë intelektual i mjeku të përkushtuar dhe me integritet të lartë njerëzor.

Kundër drejtimit burokratik të shkollës

- SHKOLLA NË FOKUSIN E GAZETARIT -



FRAN GJOKA

Problemet e drejtimit të shkollës moderne janë bërë të vështira. Sepse shkolla është bërë një institucion i më kompleks në të cilin kanë ndryshuar rolet, pozicionet dhe janë transformuar konceptet e shkollës së vjetër, të bazuar në drejtimin politik dhe ideologjik dhe në autorizimin absolut gati totalitarist të drejtuesve të saj. Në shkollën tonë të re, të demokratizuar në të gjithë hallkat dhe aksesoret e saj duket se gjërat kanë ndryshuar. Kanë ndryshuar doemos dhe raportet midis aktorëve dhe faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm që lidhen me të. Megjithatë, duket se mbarëvajtja e punëve të shkollës është e lidhur me punën dhe veprimtarinë e një figure kryesore drejtuese, që ka përgjegjësinë e drejtimit të procesit mësimor edukativ. Natyrisht duke parë rolin e drejtorit në drejtimin dhe mbarëvajtjen e punëve në shkollë, më duket se jo gjithnjë kjo figurë qendrore e shkollës dhe e drejtimit të proceseve të shumta që zhvillohen brenda saj, nuk është gjithnjë në pozicionin e duhur dhe të luajë rolin që i takon në funksion të drejtimit.

Drejtori i shkollës unifikon tërë hallkat e procesit të mësimi dhe edukimit

Kur bisedon me drejtues dhe mësues të shkollave të ndryshme, gjithnjë përballesh me eksperiencë, tipologji dhe larmi përvojash pune e drejtimi, me mënyra të ndryshme të komportimit të drejtuesit të shkollës me mësuesin, nxënësin, prindërit dhe komunitetin shoqëror. Një figurë e plotë e drejtuesit të shkollës është ai që drejton shkollën jo pjesë - pjesë dhe me hallka të shkëputura të procesit të mësimi dhe të edukimit, por në mënyrë harmonike dhe të sinkronizuar në të gjithë komponentët dhe përbërësit e saj. Shkolla është një nga institucionet që nuk funksionon pjesë - pjesë, por në mënyrë tërësore, sepse përgjithësisht shkolla nga pikëpamja e veçorive institucionale është një "institucion total". Në këtë kontekst roli i drejtorit të shkollës për unifikimin e tërë hallkave të procesit të mësimi, edukimit, kualifikimit dhe trajnimit të mësuesve, të zbulimit, përhapjes dhe përgjithësimi të praktikave më të mira të "orës së mësimi", të krijimit të atmosferës së komunikimit komunitar dhe të lidhjes së shkollës me

komunitetin e prindërve është në një farë mënyre e lidhur me aftësitë kreative, aftësitë organizuese, frymën e bashkëpunimit dhe të partneritetit që është e domosdoshme për çdo drejtues shkollë.

Drejtori i shkollës nuk është thjesht administrator

A i kemi drejtorët e shkollave në pozicionin e duhur dhe a janë ata në gjendje që të luajnë rolin që kanë marrë përsipër, apo që ju a kanë ngarkuar? Doemos një pjesë e madhe e drejtuesve të shkollave 9 - vjeçare dhe të mesme janë bërë të njohur si personalitete të njohur të drejtimit të tyre. Në shkollat tona ka drejtues me aftësi tërësore dhe njohuri të integruara të drejtimit dhe të profesionit, që dinë të krijojnë kohezionin e duhur midis mësuesve, nxënësve dhe prindërve, si një kusht themelor për efektivitetin e mësimi dhe efikasitetin socio-pedagogjik të shkollës. Por problem është se jo të gjithë drejtuesit e shkollave tona kanë staturën e drejtuesit të aftë, të liderit profesionist, që ka mundësi të drejtojë shkollën këtë institucion kompleks

socio-pedagogjik. Një pjesë e tyre vuajnë nga mangësi të ndryshme të formimit profesional, mungesa e përvojës së drejtimit nga mungesa e dëshirës për të drejtuar shkollën. Nuk është normale që kemi ende drejtues që shkollën me të gjithë kompleksitetin e saj e konsiderojnë si institucion i lehtë që mund ta drejtojnë kushdo, "mjafton që të jetë mësues". Ky mentalitet thjeshtëzues ka kosto të mëdha që i pëson drejtimi i shkollës, puna edukative, motivimi i mësuesve.

Koncepti i thjeshtë i "drejtorit" si person i administrimit të punëve rutinë të shkollës, është sipas mendimit tim një nga shkaqet që cenon nivelin e duhur shkenkor, organizativ, pedagogjik dhe social të shkollës. Drejtori i shkollës nuk është thjesht personi që administron shkollën vetëm nëpërmjet vendosjes së autoritetit formal mbi mësuesit. Ky koncept është tipik i shkollës së vjetër të tipit autoritarist, që e ndante staturën e drejtorit nga të gjithë hallkat, faktorët, komponentët dhe aktorët përbërës të shkollës, tani ka marrë fund. Në një sfond social totalitarist në të cilën funksiononte shkolla jonë në të kaluarën, mund të kish kuptim drejtimi autoritar i drejtorit të shkollës dhe fryma e disiplinës autoritariste në shkollë. Tani jemi në kohë tjetër dhe drejtori i shkollës

nuk mund të jetë i suksesshëm, nëse mendon se mund të drejtohet ajo me metodat e vjetra të autoritarizmit pedagogjik, të imponimit të mësuesit dhe të deformimit të komunikimit të tij me ta dhe nxënësit. Shumë mësues të nderuar, profesionistë të zot kanë filluar të jenë të shqetësuar me këtë fakt, që në shkollat tona ka shumë autoritarizëm fals, shumë dëshirë për pushtet formal, të mbështetur në prerogativat dhe presionet e drejtorit, jo për shkak të vlerësimit të merituar të performancës së mësuesit në punën në shkollë, por thjesht për të frenuar mendimin e lirë, alternativ të mësuesit. Nuk është drejtim efikas i shkollës nëse drejtori nuk udhëheq shkollën dhe mësuesit me dituri, përvojë dhe njohuri, por me mjete të autoritetit formal, të frikës dhe të presionit ndaj mësuesit. Është tjetër koncepti i vjetër i drejtimit të shkollës dhe krejt tjetër procesi i udhëheqjes së procesit mësimor edukativ. Mbivlerësimi i "autoritetit pa kusht" të drejtorit, shenjtërimi i pushtetit personal, atribuimi i kompetencave pa respektuar specifikën, delikatesën e shkollës si institucion i brishtë është tregues i deformimeve që i bën drejtimi shkollës.

Drejtimi i shkollës nuk është veprimtari e thjeshtë administrative, aq më pak e mbyllur në guaskën e "autoritarizmit të drejtorit". Drejtori patjetër që ka kompetenca administrative dhe prerogativa vendimmarrëse të pacenuara, që janë pjesë e përgjegjësisë së tij personale për drejtimin dhe organizimin e punëve në shkollë. Por që bësh këtë detyrë ka rëndësi optika me të cilën ai e vlerëson detyrën dhe mënyrën se si e luan rolin e drejtuesit në shkollë. Autoriteti i drejtuesit të shkollës nuk është i njëjtë me atë që punon në administratën publike apo institucionet private. Jo se shkolla nuk ka kërkesa dhe parametra të forta të drejtimit të unifikuar që e vlerësojnë dhe ridimensionojnë me sens mase rolin e rëndësishëm të autoritetit të drejtorit në shkollë. Jo, kjo nuk duhet parë në këtë kontekst, sepse shkolla në mendimin modern pedagogjik konsiderohet "institucion i disiplinës", që do të thotë se ka nevojë për disiplinë tërësore, organike, të pandërprerë dhe të gjithanshme, të cilës i nënshtrohen edhe mësuesi, edhe nxënësi. Por shkolla ka një raport të ndryshëm midis disiplinës shkencore dhe pedagogjike brenda mësimi, që lidhet me punën dhe angazhimin profesional të mësuesit dhe motivimin e nxënësit nga njëra anë dhe me atë administrative dhe ligjore nga ana tjetër.

Një drejtues që nuk komunikon me mësuesit dhe nxënësit, nuk mund të drejtojë shkollën

Në këtë kontekst drejtuesi i mirë i shkollës nuk është ai që gjithçka të "artit të drejtimit" e formalizon në gjetjen e "pikave të dobëta" të mësuesit me të cilën ai i mban nën presion, frikë, duke abuzuar kështu rëndë me detyrën e tij si drejtues. Një drejtues që nuk komunikon me mësuesit dhe nxënësit, nuk është fare i aftë të drejtojë shkollën. Shkolla nuk drejtohet ekskatedra nga zyra, as me letra. Drejtimi i shkollës është një art të cilin e zotëron ai drejtues që di të udhëheqë shkollën, mësuesin dhe nxënësin së pari me shembullin e vet, me staturën si drejtues i përkushtuar, ai që për vete zotëron profesionin dhe dituritë e duhura për të udhëhequr, jo



me forca por me logjikë shkencore, duke krijuar kohezion pozitiv në shkollë, duke motivuar mësuesin e mirë, duke qenë i hapur, parimor por dhe miqësor.

Në shkollë, shpesh për shkak të mungesës së kualiteteve të drejtimit demokratik të shkollës kultivohet një gjendje anormale punë, në të cilën nuk vlerësohet se sa efektive është puna, por sa i fuqishëm është autoriteti i drejtorit, sa peshë ka sjellja arbitrare e tij mbi mësuesit. Një drejtim i tillë i shkollës është arkaik, kundër produktiv, që nuk prodhon sinergji, nuk jep rendiment dhe nuk ka efikasitet. Një stil i tillë autoritarist në shkollat tona, shpesh shoqërohet me dukuri anti-pedagogjike dhe anti-sociale që cenojnë rëndë performancën e punës së mësuesit dhe rendimentin e shkollës. Presioni i drejtimit arbitrar, burokratik dhe jo profesional të drejtorit të shkollës vret “shpirtin krijues” të mësuesit, qëndrimin e tij aktiv si profesionist por dhe si qytetar.

Drejtuksi burokrat, dembel dhe i paafte ka dëshirë rrugën më të shkurtër të drejtimit me mjete burokratike dhe autoritariste, duke mos përfillur apo duke shkelur në shumë raste mbi dinjitetin, autoritetin shkencor, motivimin dhe personalitetin moral të mësuesit. Autoritarizmi nuk prodhon sinergji në kolektivin e shkollës, përkundrazi, ajo mpin forcat, paralizon energjitë, mbyt praktikën e mira të mësimi dhe edukimit, të cilat fashiten nën këmbët e “drejtorit autoritarist”. Ndaj në shumë shkolla kultivohet një psikologji e mësuesit pasiv, që nuk ka kurajë të thotë atë që mendon apo atë që duhet, nga që



drejtori e kërcënon duke i treguar derën e shkollës.

Prandaj është e nevojshme që drejtuesit duhet të kuptojnë thellë rolin dhe përgjegjësinë që kanë, me mënyrën e sjelljes dhe të drejtimit të punës për krijimin e situatës pozitive në shkollë, në të cilën, vendin e autoritarizmit formal, ta zëre fryma e punës dhe e solidaritetit profesional.

Dhe së fundmi: Cfarë është shkolla

e drejtorave që po trumbetohet me të madhe ! Shkolla politike e drejtorave, është gjë tjetër, vetëm një kurs trajnimi dhe zhvlerësimi që po i bëhet formimit universitar që drejtuesit e shkollave kanë vite që kualifikohen. Kjo nismë e ndërmarrë nga qeveria dhe iniciuar nga ministria po mohojnë të drejtën ligjore të Insitucioneve të arsimit të lartë, ku dihet se kanë patur si mission formimin fillestar të drejtuesve të shkollave dhe njëkohësisht

duke e legjitimuar politika të penguar të saj dhe lirinë akademike të universiteteve. “Shkolla e drejtorave” që është ndërtuar me urdhërin nga lart po e “bren” sistemin duke shpërfilluar vlerat të insitucioneve tona universitare dhe mbi të gjitha po deformojnë sistemin. Shoqëria shqiptare, ka nevojë për një proces cilësor që ti shërbejë të gjithëve, bazuar në përvijat më të mira europiane dhe botërore.

(vijon nga faqja 7)

Një kolanë e tillë do të kishte vlerë jo vetëm për letërsinë dhe kulturën shqiptare, por edhe për ndërgjegjësimin mjedisor. Nëse me kalimin e viteve do të krijohej një traditë e botimit të këtyre antologjive, do të krijohej një pasuri e veçantë dokumentare dhe artistike për mënyrën se si poetët shqiptarë e kanë parë dhe përjetuar natyrën në periudha të ndryshme.

Kjo është veçanërisht e rëndësishme sot, kur mbrojtja e natyrës nuk është më vetëm një çështje estetike apo romantike. Ajo është bërë një domosdoshmëri për të ardhmen e shoqërisë njerëzore. Pyjet, tokat, ujërat dhe biodiversiteti janë pasuri që nuk mund të zëvendësohen lehtë dhe që, në shumë raste, kërkojnë dekada apo shekuj për t’u krijuar. Prandaj, çdo përpjekje për t’i njohur dhe për t’i dashur ato është një kontribut edhe në mbrojtjen e tyre.

Në këtë këndvështrim merr një kuptim të veçantë edhe thirrja e inxhinierit Gjon Fierza drejtuar të rinjve, kolegëve të sotëm dhe atyre që do të vijnë, si dhe të gjithë atyre që e duan natyrën dhe pyjet:

“Të punojnë për to; nuk mjafton të mësoni e të fitoni një profesion. Puna juaj duhet të jetë largpamëse, duhet konsideruar si një mision. Të gjithë ata që e duan natyrën i ftoj që, krahas punës, të lexojnë dhe të shkruajnë sa më shumë poezi. Sa më shumë do ta njihni dhe vlerësoni jetën, aq më e lumtur do të jetë ajo për ju”.

Ky mesazh ka një domethënie që shkon përtej profesionit të pylltarit, inxhinierit, agronomit, biologut apo specialistit të mjedisit. Ai u drejtohet të gjithë njerëzve që kanë zgjedhur të punojnë me natyrën

dhe për natyrën. Një profesion mund të mësohet në universitet, mund të përsoset përmes përvijës dhe mund të zhvillohet përmes kërkimit shkencor. Por dashuria për atë që bën, ndjenja e përgjegjësisë dhe bindja se puna jote i shërben një qëllimi më të madh, janë ato që e shndërrojnë profesionin në mision.

Dhe mbase pikërisht këtu takohet shkenca me poezinë. Shkenca na mëson të njohim natyrën, të kuptojmë ligjet e saj dhe të vlerësojmë pasuritë që ajo na ofron. Poezia na mëson ta ndiejmë atë. Shkenca na tregon se sa i rëndësishëm është një pyll për tokën, ujin, klimën dhe biodiversitetin. Poezia na kujton se ai pyll është gjithashtu një pjesë e kujtesës sonë, e peizazhit të fëmijërisë, e vendlindjes dhe e identitetit tonë. Prandaj, një specialist që e njeh natyrën vetëm përmes të dhënave shkencore mund ta kuptojë atë, por ai që arrin edhe ta ndiejë, ta përjetojë dhe ta shprehë përmes artit, ka mundësi ta mbrojë atë me një përkushtim edhe më të madh.

Në këtë kuptim, antologjia “**Tri dëshirat e pyllit**” mund të bëhet një mjet i dobishëm edhe në edukimin e brezave të rinj. Ajo mund të përdoret në shkolla si material plotësues jashtë programit mësimor, veçanërisht në orët që lidhen me letërsinë, biologjinë, mjedisin, edukimin qytetar apo aktivitetet kulturore. Një poezi mund të bëhet pikënisje për një diskutim mbi pyjet; një varg mund të nxisë një nxënës të pyesë se çfarë po ndodh me natyrën përreth tij; një përshkrim i një lumi apo mali mund të zgjojë dëshirën për ta vizituar, njohur dhe mbrojtur atë.

Kjo është edhe një arsye tjetër pse një botim i tillë duhet të shkojë përtej bib-

liotekave personale. Ai do të ishte mirë të gjendej në bibliotekat e shkollave të të gjitha niveleve, në bibliotekat publike, në institucionet e kulturës dhe të informimit, në qendrat komunitare dhe në bibliotekat e lexuesve që kanë pasion natyrën, mjedisin dhe poezinë shqipe. Një libër i tillë nuk duhet të mbetet vetëm në duart e specialistëve të pyjeve apo të njerëzve që merren profesionalisht me natyrën. Ai duhet të arrijë tek fëmijët, tek të rinjtë, tek mësuesit, tek prindërit dhe tek të gjithë ata që nesër do të kenë në dorë fatin e pyjeve dhe të mjedisit shqiptar. Nëse një antologji e tillë arrin të bëjë që qoftë edhe një fëmijë të shohë me më shumë dashuri një pemë, të mendojë para se të dëmtojë një pyll, të kuptojë vlerën e një burimi uji apo të ndiejë se natyra është pjesë e jetës së tij, atëherë ajo e ka përmbushur një pjesë të rëndësishme të misionit të saj.

Në përmbyllje të këtij shkrimi përuroes për antologjinë poetike “**Tri dëshirat e pyllit**”, mund të themi se kemi përpara një botim që meriton të lexohet, të vlerësohet dhe të përdoret. Ai meriton të jetë një libër shtesë në bibliotekat e shkollave, një prani e dobishme në institucionet e kulturës dhe të informimit, si dhe një pjesë e bibliotekave të lexuesve pasionantë të natyrës dhe të poezisë shqipe. Vlera e kësaj antologjie nuk qëndron vetëm në poezitë që përmban, por edhe në mesazhin që përcjell: **Natyra duhet njohur për t’u dashur, duhet dashur për t’u mbrojtur dhe duhet mbrojtur që të mund t’u trashëgohet brezave që do të vijnë.**

Pikërisht për këtë arsye, kjo nismë meriton të vazhdojë. Vëllimi i parë mund të pasohet nga të tjerë. Poetë të rinj

mund t’i bashkohen kësaj kolane. Poezi të reja mund të shtohen. Tematika mund të zgjerohet. Dhe, me kalimin e viteve, mund të krijohet një pasuri e veçantë letrare që dëshmon se poezia shqiptare nuk e ka parë natyrën vetëm si peizazh, por edhe si përgjegjësi, si kujtesë dhe si pjesë të pazëvendësueshme të jetës sonë. Në këtë përpjekje, autori i botimit, anëtar i Shoqatës “Dukagjini”, Gjon Fierza, meriton vlerësim të veçantë për nismën, përkushtimin dhe guximin për të ndërmarrë një botim të kësaj natyre. Të ndërmarrësh një nismë të re pa pasur përvojë të mëparshme në botime të tilla kërkon vullnet, këmbëngulje dhe, mbi të gjitha, besim te ideja që kërkon të përcjellësh.

Prandaj, këtë botim e përshëndesim jo vetëm për atë që është, por edhe për atë që mund të bëhet në të ardhmen. I urojmë autorit suksese në botime të tjera, që kjo nismë të mos mbetet një përpjekje e vetme, por të shndërrohet në një traditë të bukur e të dobishme kulturore. Le të shpresojmë që “**Tri dëshirat e pyllit**” të mos lexohet vetëm si një libër me poezi për natyrën, por edhe si një thirrje për ta njohur më mirë natyrën, për ta dashur më shumë dhe për të punuar me më shumë përgjegjësi për ruajtjen e saj.

Sepse pylli nuk është vetëm dru.

Natyra nuk është vetëm pasuri.

Ajo është jetë, kujtesë, bukuri dhe e ardhmja jonë.

Dhe, nëse duam që brezat që vijnë të kenë mundësi të shohin e të përjetojnë atë bukuri që kemi njohur ne, detyra jonë është e qartë: **Ta ruajmë sot atë që nuk mund ta rikrijomë nesër.**

Prof. Ass. Dr. Zef Gjeta

KUSHË MICJA

- 167 VJETORI I HAPJES SË SHKOLLËS SË VAJZAVE NË QYTETIN E SHKODRËS -

Shumë është shkruar për hapjen e kësaj shkolle dhe nismëtare e saj Marie – Kushë Micja. Madje, me rastin e 100 vjetorit të themelimit të kësaj shkolle, në vitin 1959, Komiteti Ekzekutiv i K. P. të qytetit Shkodër vendosi një pllakë përkujtimore në shtëpinë e saj, me këtë mbishkrim: **“Në këtë shtëpi u hap e para shkolle femnore në Shkodër, në vitin 1859, me emnin shkolla e Kushë Mices, shkolla kje qe për 45 vjet me radhe u ba qendra e përhapjes s’ arsimit në çetën femnore në qytetin e Shkodrës”**.

Mbas vitit 1961, rrugica është restauruar, dhe me këtë rast është prishur shtëpia e Kushës dhe megjithëse është shkruar për te nuk është vendosur asnjë shenje për ta kujtuar këtë shkollë apo themeluesen e saj, Kushë Micja, kur në kominën e Gjilanit, në lagjen “Arbëria” është rrugica me emrin “Kushë Micja”!!!

Kryesia e Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, në bashkëpunim me Bashkinë Shkodër, Drejtorinë e Shkollimit Shkodër, me datën 5 shtator 2026, dite e Shtune, në ora 10.30 do të inaugurojnë vendosjen e pllakës përkujtimore për këtë shkolle dhe autoren e saj, duke zhvilluar një veprimtari të veçantë

Më poshtë po shkruajmë disa të dhëna nga shkrimtari e studiues të ndryshëm, se jo pak kane shkruar për te. Mbi jetën dhe veprën e Kushë Mices, në veçanti për shkollën e vajzave Kushë Micja kane shkruar plote, si: **Profesore Fatmira Musaj në vitet 1913 - 1039, Mikel Prenushi e Lec Coba në vitet 1961 – 1965, Profesor Njazi Kazazi, Simon Rrota, Ludovik Shllaku, Hamdi Bushati, Diaspora Shqiptare, Prof. Dr. Zenepe Dibra, Luigj Shyti e Ismail Bala, të cilët i falënderojmë për punën e tyre atdhetare, kulturore e historike.**

Diaspora Shqiptare, me 16 qershor 2020, shkruan: Kushë Micja, bija e Dukagjinit e para që shkolloi vajzat shko-

drane. Kushë Micja, ishte themeluesja e shkollës së parë për gratë dhe vajzat shqiptare. Me 1859, ajo hapi shkollën e parë për gra në Shkodër, të quajtur “Shkolla e Kushë Micës”. Shkolla u hap pavarësisht shumë pengesave të vendosura nga autoritetet turke; ceremonia e hapjes ishte e thjeshtë, por me një pjesëmarrje të mirë. Shkolla mësonte shkrim, lexim, numra (aritmetike), vizatim, këngë (muzikë) dhe punë dore. Shkolla u mbyll në 1904, pas 45 viteve nga themelimi i saj. Kusha u lind në Shkodër më 16 qershor 1832 dhe vdiq më 3 mars 1913. Familja e saj, për arsye konflikti gjakmarrjeje, u zhvendosën në Shkodër nga Dukagjini.

Për veprimtarinë e saj kanë shkruar jo pak personalitet e figura të fushës së shkollimit e letrave, si më poshtë:

Për këtë dukagjinase shkruajnë:

Një rrugë në qytetin e Gjilanit mban emrin e shkodranes Kushe Mica, në lagjen Arbëria

Kushë Micja, themeluesja e shkollës së parë për gratë e vajzat shqiptare. Më 16 qershor 1832 në Shkodër lindi Kushë Micja, themeluesja e shkollës së parë për gratë dhe vajzat shqiptare. Familja e saj, për arsye konflikti gjakmarrjeje, u zhvendosën në Shkodër nga Dukagjini, krahina e Shllakut. Filloi të jepte mësim në moshën 27-vjeçar. Një grua e vetë mësuar, për dhjetë vjet studioi me farmacistin venecian Shjor Marko Rebeskin dhe u thellua në gjuhët frënge dhe italiane. Në vitin 1859, hapi shkollën e parë për gra në Shkodër, të quajtur “Shkolla e Kushë Micës”, ku jepej shkrim, lexim, numra (aritmetike), vizatim, këngë (muzikë) dhe punëdore. Shkolla u mbyll në vitin 1904, 45 vite pas themelimit të saj. Nuk arriti të bëhej e njohur si shkolla e parë shqipe për arsyen se programi arsimor nuk ishte i dokumentuar dhe Kushë Micja nuk ishte në nivelin e duhur arsimor.

Profesor Njazi Kazazi, me titull “Zh-

villimi i arsimit të mesëm në Shkodër” dhe për Kushë Micën shkruante: *“Në Shkodër u arrit që në vitin 1862 të hapet një qendër mësimore shqipe (private) për vajza nga Kushe Mica dhe Tereze Bërdica dhe më vonë edhe shkolla e Tina Nikes, (për të cilat kimi folur edhe tek shkollat femërore) dhe janë botuar edhe disa shkrime në shtypin tonë shkencor”,* në faqen 17.

Simon Rrota, te libri me titull “Për vedi e për Shkodrën”, në faqen 41 shkruan: *“Po në këtë rrugë ishte edhe një shkollë tjetër, ajo e Kushe Mices, vetëm për vajza sa për punë dore”*.

Ludovik Shllaku, shkruan: *“Në Shkodër, p. sh. të tilla kanë qene shkolla e Kushe Mices (1859-1897), me 86 vajza e dy mësuese, shkolla e Tina Nikës (Gjergji), e cila e filloi jetën e saj në vitin 1873-1874, ..., në faqen 52.*

Hamdi Bushati, te libri “Shkodra në Motë”, pjesa e dytë, në faqen 42 shkruan: *“... Kushë Micja-Në vargun e shkollave private të ndihmuar prej qytetarëve katolik, por dhe të shpërblyera nga Austro-Hungaria janë për tu shënuar dhe tri shkolla të mbajtura prej tri mësuesve shkodrane. Shkolla e Kushë Micës ishte më tepër për punë dore dhe për pak këndim e shkrim. Kusha sipas dokumenteve të kishtarë të famullisë Shkodër, ka lindur me 16 qershor 1832, prindërit e saj ishin të ulur nga Dukagjini. Kusha kishte ndejtur virgjëreshe. Ajo kishte marre mësim nga Shor Marku, për të cilin kemi shkruar më sipër, prandaj në shkollën e saj mësonte italisht. Ajo hapi shkollën në vitin 1859, vdiq në moshën 75 vjeçare, me 3 mars 1913. Si argument për ekzistencën e këtyre shkolla femërore katolike të asaj kohe ju riprodhojmë një kopje të origjinalit, që është gjetur në arkivin e Arqipeshkvisë Shkodër.*

Nder dokumente bëhet fjalë rreth një ndihme të vogël që iu dha mësuesve të Shkodrës qeveria austro-hungareze. Që një kopje e tekstit të përkthyer nga italishtja: “Për 7 florinta, që na të nenshkrueset mësuese e Shkodrës vërtetojmë se kena marre

prej Monsinjur Paskuele Guerinit si ndihmë të dhenë prej Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vien, për shkollat fillore të semestrin e parë të vitit 1885-86, me shkresën 12 mars 1886.

Marie (Kushë) Mici Terezina Bërdica

Prof. Dr. Zenepe Dibra, te libri “Enciklopedia e femrës shkodrane”, në faqen 48, shkruan: “Micja, Kushë-1832-1913, Mësuesja e parë e një shkolle femërore. Lindi në Shkodër, në një familje të ardhur nga Dukagjini. Nga studimet e fundit nuk dihet ekzaktesisht vendi i lindjes, por ajo njihej prej të gjithëve me origjinë të hershme shkodrane. Kishte mbaruar një shkollë, që e kishte hapur një italian Shjor Mark Rebeskini në Shkodër, në vitin 1855. Kusha zotëronte italishten dhe frëngjishten në një nivel të mjaftueshëm intelektual për një femër të asaj kohe. Ka hapur shkollën e parë femërore (shih) në Shkodër, në vitin 1862. Ajo ishte shkollë private femërore me ndërtesë në shtëpinë e saj, në rrugën “Vasiej”, në lagjen Serreq. Si ndihmese ajo pati dhe një mësuese tjetër, Tereza Bërdica. Lista e nxënësve, që kanë qenë në këtë shkollë, të shkruar nga dora e Kushe Mices, është ruajtur deri vonë. Kusha dha mësim në këtë shkollë, për afro 35 vjet. Kur vdiq u përcoll me shumë respekt nga shumë banorë shkodrane, burra e gra të qytetit. Shumë prej tyre mbyllën dyqanet në Pazarin e Vjetër për ta përcjellë në banesën e fundit. Deri vonë, para ndërtimit të disa godinave sipas planit rregullues, në derën e oborrit të shtëpisë të kësaj shkolle ka qenë një pllake përkujtimore, në nderim të shkollës së parë femërore.

Luigj Shyti, ka botuar për Kushë Micën, me titull “Kushë Micja, bija e Dukagjinit e para që arsimoi vajzat shkodrane”, botuar në gazetën “Shkodra”-2002 dhe në librin, me titull “Dukagjini ka vend për të gjithë”, faqe 122-124: Është thënë dhe rithënë se malësori natyrshëm është inteligjent, ka dëshirë dhe guxim për punë, për ndryshim dhe përparim pavarësisht se kushtet dhe koha nuk kane qene shpesh here në favorin e tij. Ata njerëzishëm e thonë fjalën e tyre për të kaluarën dhe të tashmen, për mikun dhe për bijën, për lypësin dhe të pasurin, për shtegtarin dhe gjahtarin, për bujkun dhe për bariun e të tjerë.



Foto e shkollës së vajzave në Shkodër e vitit 1914.
Foto nga farmacistin venecian Shjor Marko Rebeskin.
Kusha nuk është këtë foto, se ajo ka vdekur me 3 mars 1913



Një rrugë në qytetin e Gjilanit mban emrin e shkodranes Kushe Mica, në lagjen Arbëria

Një bijë e këtyre maleve “rrokë me re”, qe dhe Kusha e Mic Jakut, lindur në Shkodër, me 16 qershor 1832. Familja e saj ishte nga Dukagjini, por ardhur në Shkodër, për shkaqe hasmërie. Ajo pati dhe një vëlla, Ndreken, që u bë krah dhe ndihmës i saj i përhershëm. Kusha nuk u martua kurrë, por edhe Ndreka edhe pse u martua nuk pati trashëgimtar.

Kusha mori dije e kulture dhe mësoi edhe gjuhët frëngjisht dhe italisht. Duka trashëguar vetitë bujare të fisit të vet, ajo bashkoi me to edhe kulturën e gjerë që munda të fitonte.

Si një malësore guximtare, e shkathtë, e hijshme dhe plotë inteligjencë, vendosi të hapte një shkollë për vajzat e qytetit, për të mësuar ato në gjuhën e nenës. Pas shumë përpjekjesh munda që në muajin gusht të vitit 1859 të realizonte hapjen e shkollës që populli e pagëzoi “Shkolla e Kushë Micës”. Objekt për shkollën përdori shtëpinë e saj, në lagjen “Sarreq”, në ish rrugicën “Vasiej”.

Punën e mësueses e filloi në moshën 27 vjeç dhe për 45 vjet nuk e ndërpreu asnjëherë. Shkolla u mbyll në vitin 1914. Në shkollën e Kushë Mices mësohej shkrim, këndim, numratore (matematike), vizatim, kënge e punëdore. Kujdes të veçantë tregonte për shkrimin e bukur. Në mësimin e numëratores krahas veprimeve të mbledhjes, zbritjes, shumëzimit dhe pjesëtimit, tregohej kujdes edhe për vlerat e parave të kohës, masat, peshën e të tjera. Vizatimi ishte i lidhur edhe në funksion të punës së dorës, ndërsa për këngën nuk përdorehin orë të veçanta, por zhvillohej ndërsa vajzat bënin punë dore dhe përgjithësisht kishin melodi fetare. Pasi e dëgjoni disa here nga mësuesja e këndonin vajzat gjate punës së dorës. Në orët e mësimave të punëdore vajzat punonin edhe kopshtin e shtëpisë së mësueses, prodhimet e të cilit një pjesë u a jepte nxënësve të saj në formë dhurate.

Gjithmonë ajo kishte në shkolle mbi 50 nxënës të ndara në dy dhoma mësimi sipas shkalleve të ndryshme të njohurive. Paradite zhvillohej shkrim, këndim, numratore dhe vizatim e pasdite këngë dhe punëdore. Për mbajtjen e mësueses dhe shpenzimet e shkollës investonte populli i qytetit vullnetarisht.

Në vitin 1959, me rastin e 100-vjetorit të hapjes së kësaj shkolle, Komitetit Ekzekutiv dhe Komiteti i Partisë së Punës së rrethit Shkodër, vendosi një pllake përkujtimore në shtëpinë ku ishte shkolla, me këtë mbishkrim: **“Në këtë shtëpi u hap e para shkollë femërore në Shkodër, në vitin 1859, me emrin e Kushë Micës, shkollë kjo që për 45 vjet me radhë u bë qendra e përhapjes së arsimit në çetën femërore në qytetin e Shkodrës”**

Kjo pllake përkujtimore u prish në muajin maj të vitit 1961, për shkak të rregullimit të qytetit dhe nuk u vu me askund.

Vdekja e Kushë Mices, me 3 mars të vitit 1913 e ndërpreu punën e saj, por jo kujtimin, përpjekjet dhe rezultatet e kësaj mësuesja atdhetare e te palodhur në ato kohë të vështira dhe jo pak, por gati i gjysmë shekulli.

Me emrin e Kushë Mices krenohet një qytet i tërë, por veçanërisht malësoret dukagjinase, për bijën e tyre burrneshe.

ISMAIL BALA, QENDRA MËSI MORE E KUSHË MICES NË SHKODËR, GUSHT 1859

Sot, kur qyteti e në fshat, nga fshati në malësi, nga Veriu në Jug, në skajet më të largëta dhe më të nalta t’ atdheut tonë Partia dhe Pushteti i kane çilë sytë popullit tue krijue për te shkolla të çdo tipi me një përgatitjeje të gjithanshme t’ arsimtarëve, ku ecet me një plan të caktuem dhe me program të veçante të ndamë simbas moshave, me tekste shkollore për nxanes dhe materiale didaktike për mësues, na shkon mendja në shkollën e pare, që u hap në muajin gusht te vitit 859 në Shkodër, për t’u mësua vajzave shqiptare gjuhen e nanës dhe që njihët me emrin: Shkolla e Kushë Mices.

Mos te mendoje kush se shkolla e Kushë Mices u quajt shkolle për të mbledhë pak nxanës, sa me kalua kohën, për të mësua disa shkronja, sa me njohtë alfabetin, për të bubërrua ndopak pune dore sa me zbavite vajzat. Të flasësh për mësues Kushë Micja, do të thotë të njohësh me një vajze të kulturue, që karrierën e mësuesisë e filloi në moshën 27 vjeçare dhe që për vullnet të popullit të Shkodrës dhe me iniciativën e tij, hapi të paren shkolle shqipe në Shkodër, me qelim që të ngrejë çetën femnore në lamën e arsimit dhe të kulturës. Nen parullën: “Kurrja për vehte dhe gjithçka për të tjerët – ajo mblodhi për 45 vjet me radhe vajza nga shtresa e vorfna të popullit, ua zhvilloi mendjen, ua edukoi shqisat, ua pranoi duert.

Asht interesant të shikosh edhe sot ato pak plaka nandëdhjetëvjeçare, që kane mbete nga kjo shkolle e vjetër kah ndo’ i here kalojnë lagjes “Serreq”, se si ngadalësojnë hapin kur mbërrijnë në rrugicën “Vjerrdhaj” për të dallua diçka të mbetun nga kjo ndërtesë e rrezueme. Flasin edhe gojë në gojë njëra me tjetrën, duket sikur bisedojnë rreth mësueses Kushë Mices, për të cilën ruajnë kujtimet mi të bukurat e fminisë së tyre.

RRETH JETËS SË KUSHËS DHE PUNËS ARSIMORE TË SAJ TASHTI ÇDO GJË ASHT E QARTE.

Kusha lindi me 16 Qershor 1832. Fisi i saj qe dukagjinase, i ulun në Shkodër qe herët për shkak gjaqesh. I ati Mic Jaku (edhe sot nder malësinë përdoret emni Mici, Mican), pat edhe një djalë Ndreke Micin, i cili i vlejti shumë Kushës ne çështjen administrative. Kusha s’qe martue dhe vëllai i martuem s’ pat femi. Me vdekjen e tyne mbyllet fisi i Micajvet.

Kusha pat një kulture të gjane dhe zotnonte gjuhen frënge dhe italiane. Ketë dituni e muer prej Shjer Marko Rabsakini. Ishte ky një farmacist Venecian eksponent i partisë republikane. Ne kundërshtim me vijën politike. Kusha ishte me vetitë bujare të fisit të vet, bashkoi me to edhe kulturën e gjane qe muer si nxënës shkolle. E forte fizikisht, e hijshme në fytyrë, e nalte me shtat, me një sjellje shembullore dhe e pajisun me një inteligjencë të mprehte, populli i Shkodrës shikonte te ajo mësuesen e ardhshme të fëmijëve të tij. U deshën dy vjet vështirësish dhe pengesash nga ana qeveritare për t’u mbledhë populli i Shkodrës në një ceremoni të thjeshte, por plote emocion, në gusht të vitit 1859, që të hap shkollën e pare laike shqipe e që muer em-

rin shkolla e Kushë Mices.

Kusha vazhdoi të mësojë deri në moshën 72 vjeçare. Në vitet e fundit i u paralizua një kambe sa me e pengue rande vazhdimin e shkollës. Edhe shume janë në Shkodër, që e mbajnë mend plaken e vlerite kahe ece me shkop në dore, në mbramjet e freskëta të pranverës dhe të verës, ecte ngadalë neper rrugët e lagjes se vete ne te tana sjelljen e saj shkëlqente edhe nder rrudhat e pleqnise ajo fisnike, qe kishte qene fryma e jetës se saj.

Lajmi i vdekjes së Kushës me 3 mars 1913 qe përhapë me shpejtësi të madhe. Kujtdo iu dhimbte dhe s’ mbet grue pa derdhe lot. Burrat e pazarit e lanë punën, që në dreke dhe u ngjiten ne qytet për te marre pjese ne varrimin e saj. I madh dhe i vogël eci për ta përcjellë ne pushimin e mbarmë. Një popull aq i madh s’ ishte pa deri atëherë në varrime. Shkodra i bani nderimet e duhuna mësueses, që shkrini jetën e vet për fëmijët e saj.

Puna mësimore në shkollë

Tashti le te njihemi me shkollën e Kushës, me lendet mësimore dhe zhvillimin e tyne si dhe format e ndryshme qe përdori ne çështjen e mësimi.

Së pari, si lokal shkollos, Kusha përdori shtëpinë e vet. Kjo ndërtesë e vendosun ne rrugicën “Vasiej”, ne lagjen Sarreq, ishte dy katesh, me tri dhoma, një kuzhine dhe një çardak. Një dhomë nga e majta e te hymnit dhe çardaku përdorehin për shkolle, ndërsa pjesa tjetër mbahej për banim të Kushes dhe të vëllait te saj, Ndreke Micit. Kusha kishte edhe një kopsht me peme, ma te shumtën kumbulla dhe fiq. Kallxojne se si një pjese te fryteve e thante për dimën, një pjese u’a shpërdante nxënësve, kurse pjesën tjetër e piqte raki.

Për sa u përket orendive të shkollës, ato ishin te pakta dhe te thjeshta. Mësuesja kishte për vehte tryeze dhe karrige, ndërsa nxënësit përdorehin banka te gjata me një dërrasë mbështetëse mbrapa. Shpesh për mungese bankash viheshin edhe stola një vendëse, kurse për pune dore, mbas dreke uleshin mbi jastëkë te vegjël, qe i sjellshin nga shtëpia.

Duhet pas parasysh se për mbajtjen e mësueses dhe shpenzimet e shkollës mendonte populli i Shkodrës, i cili ne lufte te vazhdueshme per liri dhe pavarësi, luftonte njohërit edhe per përhapjen e arsimit.

Me rastin e 100 vjetorit të themelimit te kësaj shkolle, në vitin 1959, Komiteti Ekzekutiv i K. P. të qytetit vendosi një lapidar, me këtë mbishkrim: **“Në këtë shtëpi u hap e para shkolle femnore në Shkodër, në vitin 1859, me emnin shkolla e Kushë Mices, shkolla kje qe për 45 vjet me radhe u ba qendra e përhapjes s’ arsimit në çetën femnore në qytetin e Shkodrës”**

Nga orenditë e shkollës dhe mjetet qe përdori Kusha për mësim, kurgjje nuk ka mbete; ndërtesa shkollore, e cila mbahej ne kambe mbas një shekulli e gjysmë, ne maj te këtij viti u rrënua për rregullim te planit te qytetit.

Kusha mbante ne shkolle mbi 50 nxënës mosha te ndryshme, qe nga 9 – 14 vjeç, me një shkolle diturie te ndryshme dhe te gjatje mesojshin ne dy dhoma, ne forme shkolle me klasa kolektive. Mësimi

fillonte paradreke qe nga ora 08.00 deri ne ora 14. 00 dhe vazhdonte mbasdreke me mësimin e këngës dhe te punës se dorës.

Lendet mësimore ishin:

- 1)Shkrim
- 2)Këndim
- 3)Kumratore
- 4)Vizatim
- 5)Kange
- 6)Pune dore

I. Shkrimi: Si metode pune për shkrim, Kusha e ndau mësimin në tri faza:

Faza e Parë: Njohje e shkronjave t’ alfabetit veç e veç, qe nga fillimi e deri në fund, shkrim i tyne me bojë. Mbas shkrimit të çdo shkronje bahej edhe leximi i tyne.

Faza e dytë: Bashkimi i shkronjave dhe formim fjalësh. Per kete lloj pune përdorej forma e vjetër e te mësuarit:

be + a = ba
be + e = be
bea + ba = baba
bea + ba
be + i = bi e te tjera

Faza e tretë: Formimi fjalish dhe diktim vjershe me karakter femëror...

Duhet theksua se këndimi e shkrimi përziheshin bashke dhe se Kusha përdori alfabetin e vjetër shkodran me karakteristika e veçanta te disa bashkëtingëlloreve

Kusha pat kujdes t’u mësonte nxënësve te shkruajnë qe nga fillimi me boje, pastër dhe me një shkrim te bukur. Kjo vërtetohet nga një fletore e vjetër qe kam, te cilën koha 90 vjeçare s’ ka mujte me zhduke shkrimin e pastër dhe te bukur te një nxënëseje te Kushës. Asht interesant me pa ne këtë fletore plot vjersha, se si mbas çdo vjershe asht ba një vizatim figurativ, ku paraqiten zogi, zemra, lule të ndryshme e te tjera.

III-Numëratoreja: Mësimi i numëratores në shkollën e Kushes përshtatej në njohjen e në shkrimin e numrave në veprime të thjeshta mbledhje, zbritje, shumëzim dhe pjesëtimi në formë praktike. Epeshin njohuni rudi - mentale edhe mbi vlerën e pareve t’ asaj kohe, mbi masat dhe mbi peshën.

IV-Vizatimi: Vizatimi zëntë një vend me rendësi në shkollën e Kushës mbasi lidhej kryesisht me punën e dorës dhe ishte ndihme e madhe për te. Qëllimi kryesor i kësaj çështje ishte të mësuarit e nxanësve, të cilëve u a përgatiste ajo ma përpara. Sigurisht modelet i a shpjegonte element për element pranë tryezës së vet çdo grupi nxënësish, mandej secila kopjonte nder flete të holla modelin e spjeguem, tue ndihmue here mbas here nga vete mësuesja. Këto punime së pari ishin të thjeshta, por ma vone ndërlikoheshin në forma të ndryshme dhe hidheshin në pëlhura të veçanta, ne mbas drekën në mësimin e punës se dorës.

V-Kanga: Ore te veçanta per mësimin e kanges, Kusha nuk perdorte, por mbas dreke, vjershat e mësue me përmendsh këndoheshin lehte e lehte nga mësuesja, ndërsa vajhzat bajshin pune dore. Kangen e nderpritete sa here paraqitej nevoja per t’u ardhe ne ndihme t epuns se dorës vajzave te shkollës. Mbas disa herësh se dëgjimit, kanga përcillej nga zanet e vajzave. Kamget kishin melodi fetare.

VI- Pune dore: Mbas dreke shkolla e Kushes Mices vlonte si blea nga vajzat që vijonin me mësue pune dore. Të ndry-

shme ishin punët e dorës, qe mësonte Kusha dhe për këto ajo kishte duer ari. Puni-met ma kryesore ishin ato qe përdorëshin për paje nusesh si: gjokse këmishash, e te tjera...

Në gazetën “Dukagjini”, nr. 3, muaji shkurt 2004, dhe në librin “Dukagjini, Shqipëria ime aty”, pjesa e III-Publicis-tike, shkruhet:

Kushë Micja e Dukagjinit e para mësuese shkodrane. Njëqind katër dhjete e pesë (145) vjet më pare, në muajin gusht 1859, Kushë Micja e bija e Mic Jakut nga Dukagjini, krahina e Shllakut, lindur e rritur në Shkodër, hapi shkollën e parë private për femra, duke thyer një tabu absolut për kohën, kur femrës i ndalohej kategorisht një gjë e tillë.


Shumë pak, për të mos thënë aspak emnin e kësaj gruaje fisnike e virtuoze njihet nga dukagjinasi.

Kryesia e Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, në mbledhje të veçantë diskutoj dhe mori vendimin, me nr. 265, me datë 15 shkurt 2022:

1-Të krijohet simboli “**Mirënjohja mësuese Kushë Micja**”, me të cilën do të nderohen mësuesit, nxënësit e studentet dukagjinase, ose me origjine dukagjinase

Me datën 13 mars 2022, me këtë medal-jon u nderuan 31 nxënëse e nxënës dhe 6 mësuese e një mësues. Gjithsejte 38 vetë. Për secilin është dhanë diploma përkatëse ...

Me datën 13 mars 2022, me këtë medal-jon u nderuan 31 nxënëse e nxënës dhe 6



mësuese e një mësues. Gjithsejte 38 vetë. Për secilin është dhanë një diplomë ...

Nga zonja Jona Leqeja, anëtare e Këshillit të Bashkisë Shkodër, është propozuar për ta nderuar me titullin “Qytetare nderi e qytetit Shkodër”, znj. Kushë Micja, pas vdekjes:

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASH-KIA SHKODËR KËSHILLI BASHKIAK
Nr. ____ prot. Shkodër, me 12.8. 2026

Drejtuar: Këshillit Bashkiak Shkodër
Kryetari Bashkisë Shkodër

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1 Shkodër,
web: www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail:
keshillibashkiak@bashkiashkoder.gov.al,

Lënda: Propozim për dhënien e titullit të nderit “Qytetare Nderi e Bashkisë Shkodër” znj. Kushë Micja (pas vdekjes)

I nderuar z. Kryetar, Të nderuar këshilltarë, Në cilësinë e anëtarëve të Këshillit Bashkiak Shkodër, bazuar në nenin 9, pika 1.7, shkronja “a” të Ligjit nr.

139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, si dhe në kompetencat e Këshillit Bashkiak për dhënien e titujve të nderit, paraqes për shqyrtim dhe miratim pranë Këshillit Bashkiak propozimin për dhënien e titullit: “Qytetare Nderi e Bashkisë Shkodër” (pas vdekjes) për: KUSHË MICJA (1832–1913), si shenjë mirënjohjeje dhe vlerësi-mi të lartë institucional për kontributin e saj të jashtëzakonshëm në historinë e arsimit shqiptar, emancipimin e gruas shqiptare dhe zhvillimin kulturor e shoqëror të qytetit të Shkodrës. Kushë Micja, e lindur në Shkodër më 16 qershor 1832, konsiderohet ndër pionieret e arsimit femëror shqiptar dhe themeluese e shkollës së parë për vajza në qytetin e Shkodrës, e njohur gjerësisht si “Shkolla e Kushë Micës”. Ajo hapi këtë shkollë në vitin 1859, në një periudhë kur edukimi i vajzave përbënte një sfidë të jashtëzakonshme shoqërore dhe kulturore. Për më shumë se katër dekada, Kushë Micja iu përkushtua misionit fisnik të arsimit të vajzave shkodrane, duke kontribuar drejtpërdrejt në ngritjen e nivelit kulturor dhe emancipues të gruas shqiptare. Në shkollën e saj mësoheshin shkrim, lexim, aritmetikë, vizatim,



muzikë, gjuhë të huaja dhe punëdore, duke ofruar një model arsimor për kohën. Kontributi i saj është vlerësuar nga studiues të njohur të historisë së arsimit dhe të qytetit të Shkodrës, ndër ta Profesore Fatmira Musaj në vitet 1913 - 1039, Mikel e Rober Prenushi e Lec Çoba në vitet 1961 – 1965, Profesor Njazi Kazazi, Simon Rrota, Ludovik Shllaku, Hamdi Bushati, DIASPORA SHQIPTARE, Prof. Dr. Zenepe Dibra, Luigi Shyti e Ismail Bala, të cilët i falënderojmë për punën e tyre atdhetare, kulturore e historike të cilët e rendisin ndër figurat më të rëndësishme të arsimit dhe emancipimit shoqëror në Shkodër.

Megjithëse figura e saj gëzon sot respekt të gjerë akademik dhe qytetar, Bashkia Shkodër ende nuk i ka akorduar një titull të lartë nderi institucional. Dhënia e këtij titulli do të përbënte një akt të merituar historik dhe moral ndaj një prej grave më të shquara të qytetit tonë. Kjo nismë buron edhe nga lidhja e veçantë që Shoqata “Dukagjini” ndjen me figurën e Kushë Micjes, e cila rridhte nga një familje me origjinë nga treva e Dukagjinit dhe përfaqëson në mënyrë dinjitoze vlerat më të mira të kësaj krahine. Për sa më sipër, propozoj që Këshilli Bashkiak Shkodër të shqyrtojë dhe miratojë projektvendimin për akordimin e titullit: “Qytetare Nderi e Bashkisë Shkodër” (pas vdekjes) për znj. Kushë Micja.

JONA LEQEJZA

Përgatiti për botim

Ndue Sanaj dhe Dukate Bregu

Pashko Camaj (Blinishta) - Në udhën e Amshimit

Sapo mora vesh lajmin e hidhur se Pashko Camaj (Blinishta) mori udhën për në amshim. Në këtë muaj të përflakur pushimesh, ti u nise papritur, me vrap, drejt udhës së pushimit të pasosur!

Që kur isha nxënës në gjimnaz, të njoha si një mësues korrekt, të përkushtuar dhe me një ndjenjë të lartë përgjegjësie.

Pashko Blinishta ia kushtoi gjithë jetën dhe energjitë e tij intelektuale, metodike e edukative brezave të rinj. Pas përfundimit të studimeve pedagogjike dhe më pas atyre të larta, ai iu përkushtua pa u lëkundur shkollimit deri në ditën e pensionimit.

Për më shumë se dyzet vjet punoi dhe edukoi dhjetëra e dhjetëra breza nxënësish në Shalë, Malësi të Madhe dhe më gjerë, në arsimin bazë e të mesëm, si mësues dhe si drejtues shkolle. Ishte njeri komunikues, i disiplinuar dhe i përkushtuar ndaj profesionit, me një pasion të pandërprerë për punën, që nga dita e parë e deri në ditën e fundit të shërbimit të tij.

Pashko Blinishta kishte një bagazh të pasur dhe të kompletuar intelektual. Ishte njohës i kulturës, historisë dhe traditave tona, të cilat nuk i mbajti vetëm si dije, por i kultivoi me përkushtim në familje, në shkollë dhe në shoqëri.

Te ai shikoja njeriun e lexuar, mikun e përhershëm të librit. Dhe kjo është një cilësi që, për fat të keq, sot nuk e gjejmë

gjithmonë te mësuesi. Dikur libri ishte pjesë e pandarë e formimit të tyre; sot, jo rrallë, mes mësuesit dhe librit ka mbetur një takim i rrallë, ndërsa ekrani dhe rrjetet sociale kanë zënë shumë prej hapësirës që dikur i përkiste leximit.

Pashko Camaj ishte edhe një veprimtar i dal-luar shoqëror për dekada të tëra. Ishte pjesëmarrës i rregullt në veprimtari kulturore, recitime, shfaqje artistike, vallëzime dhe grupe të ndryshme kulturore. E shihje gjithmonë elegant, por pa bujë; të veshur thjeshtë, pastër dhe bukur. Ishte njeri serioz, pa vese, kundërshtar i vulgaritetit dhe i çdo shfaqjeje të panevojshme.

Ishte mik i mirë i cigares dhe i kafesë, por kurrë i gotës. Ishte mik i dashur i librit dhe i shtypit. Në komunikim ishte i aftë në dialog, lakonik në shprehje dhe, mbi të gjitha, i vëmendshëm ndaj mendimit të kundërt. Dinte të dëgjonte. Dhe kjo është një cilësi e rrallë, sidomos te njerëzit që kanë një formim të gjatë intelektual.

Pashko Camaj ishte ndër emrat theme-

lues të Gazetës “Dukagjini”. Që nga numri i parë ishte bashkëpunëtor i saj i përhershëm, korrespondent, kritik dhe zë i urtë në faqet e saj. Me “Dukagjinin” bashkudhëtoi në çdo numër, duke i dhënë asaj jo vetëm shkrimin, por edhe përvojën, kulturën dhe integritetin e tij.

Ishte gjithmonë anëtar e veprimtar, aktivist i Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, ku përvoja, integriteti dhe fjala e tij e mençur ishin gjithmonë të çmuara. Dhe për këtë kontribut të vlefshëm në realizimin e misionit të Saj, është nderuar me titullin “100 vjet arsim e kulture në Dukagjini” si dhe “Mirënjohja e mësuese Kushë Micja”.

Pashku bëri një jetë aktive. Kishte energji, dëshirë për punë dhe për të qenë pranë njerëzve, pa u marrë me numrat e viteve. Prandaj ikja e tij është e parakohshme, e dhimbshme dhe e padëshiruar.

Për intelektualë të pa njollosur nga stuhitë e moteve, për njerëz të drejtë, mëndjehapur, dashamirës ndaj shkollës, kulturës, jetës, atdheut dhe fëmijës, kemi



nevojë t'i kemi sa më gjatë në mesin tonë.

Pashko Camaj, së bashku me bashkëshorten e tij, Marien, infermiere të talentuar dhe të përkushtuar, rriti dhe edukoi një familje shembullore, të arsimuar, të kulturuar dhe me vlera, ku secili prej tyre ka ndërtuar jetën dhe punën e vet me dinjitet.

Pushofsh në paqe, profesor Pashko!

Ngushëllime familjes, të afërmeve, miqve, kolegëve dhe të gjithë atyre që patën fatin ta njohin!

Largimi yt ka prekur shumë breza nxënësish, sot flokëthinjur, nga mbarë Dukagjini, Malësia e Madhe dhe Shkodra. Ata që dikur të dëgjonin në bankat e shkollës, sot të përcjellin me dhimbje në udhën e fundit.

Sot libri humbi një mik të dashur, një njeri që nuk iu nda gjatë gjithë jetës!

Shkolla humbi një mësues!

Kultura humbi një veprimtar!

Shtypi humbi një bashkëpunëtor të urtë!

Shoqëria humbi një njeri të mirë!

Dhe ne humbëm Pashkon, njeriun e thjeshtë, të kulturuar e të përkushtuar, që kurrë nuk rrahu gjoksin për veten dhe nuk ngriti flamuj autolëvdatash!

Ai iku ashtu siç jetoi: me thjeshtësi, dinjitet dhe pa zhurmë.

U prehsh në paqe, Pashko Camaj!

Amshimi qoftë i lehtë për ty, mik i librit, i shkollës dhe i njerëzve!

PRELE MILANI

Konsullatat e naivititetit, diplomacia e vogël dhe loja e madhe gjeopolitike!



Vendimi për hapjen e konsullatave të ndërsjella midis Shqipërisë dhe Serbisë, ka aktualisht disa mënyra interpretimi në diskursin publik. Ndërsa elementet kryesore të këtij debati, lidhen kryesisht me vlerësimin e funksionit dhe rëndësisë së konsullatës serbe në Shkodër, si dhe konsullatës shqiptare në Luginën e Preshevës, si dhe pragmatizmit të njëanshëm politik të hapjes së tyre. Megjithatë dominon diskursi se shqiptarëve po u shitet si "reciprocitet" njeri nga aktet më makabre të nënshtrimit të tij diplomatik. Dhe se kjo është hapje e dyerve të Veriut të Shqipërisë interesave gjeopolitike dhe gjeostrategjike të Serbisë. E se kjo seli diplomatike në kryeqendrën e Shqipërisë Veriore në Shkodër, po i bëhet dhuratë Beogradit me vetëdije, duke rrezikuar pasojat të rënda për vendin.

Këto raportime se Serbia do të hapë një konsullatë në Shkodër nuk janë thjesht një lajm diplomatik. Ato janë provë shumë serioze për shtetin shqiptar, për politikën e Tiranës dhe vetë ndërgjegjen dhe interesin tonë kombëtar. Sepse ka momente kur historia nuk vjen me tanke. Ajo vjen me dokumente, dhe me vendime qeveritare, dhe me heshtjen e atyre që detyrë kanë mbrojtjen e interesit kombëtar.

Shkodra nuk është një qytet i rëndomtë. Shkodra është themeli mbi të cilin u ndërtua identiteti ynë kombëtar. Shkodra është qyteti i qëndrësës, i kulturës, i identitetit tonë kombëtar, i dijes dhe sakrificës. Shkodra është qyteti që nuk u përkuh e nuk u mposht as para pushtuesve e as para perandorive. Shkodra është emblema e identitetit tonë kombëtar dhe vetë shqiptarisë. Dhe nuk është e rastit që Serbia ka mësyre pikërisht Shkodrës. Kjo është e menduar dhe planifikuar me hollësi. E Serbia, ka kohë që shfaqë pretendime të hapura territoriale ndaj saj, duke e quajtur djep të kulturës serbe. Prandaj çdo vendim që lidhet me Shkodrën nuk është thjesht administrativ. Është kombëtar. Prandaj gabojnë ata të cilët hiqen sikur nuk e dinë, se ky vendim nuk është as administrativ e as protokollar. Ky është një vendim shumë serioz që prekë thelbin e interesit tonë kombëtar.

E historia kërkon kujtesë:

Serbia nuk ka mbyllur kapitullin e konfliktit dhe përgjegjësisë ndaj shqiptarëve. Dhe veprimet nuk duan naivitet. Sepse kur një shtet nuk arrin të mbrojë interesin e tij shtetëror, të tjerët përpiqen të depër-

tojnë e t'i përparojnë të tyret. Dhe shqiptarët e kanë paguar shtrenjtë naivitetin e tyre historik! E historia nuk kërkon nga ne hakmarrje. Historia kërkon kujtesë.

Shikuar nga një perspektivë analitike, vet konsullata nuk kufizohet vetëm në ofrimin e shërbimeve konsullore për qytetarët e një shteti në territorin e një shteti tjetër. Ky është shërbimi më i paktë që ajo bën, dhe funksioni më i vogël që ajo mund të ketë. Konsullatat përbëjnë instrumente të politikës së jashtme, të cilat shërbejnë për zhvillimin e kontakteve politike, ekonomike, kulturore, informative dhe institucionale.

Prania e pretenduar konsullore e Serbisë në Shkodër, duhet analizuar në kontekstin më të gjerë të interesave historike dhe gjeopolitike të Serbisë, në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Është botërisht e njohur narrativa serbe dhe pretendimi i vjetër serb, për Shkodrën dhe kështjellën e saj si qendër e kulturës serbe. Është kjo pjesë e një diskursi që herë pas here shfaqet në mediat dhe qarqet nacionaliste

sotme për të forcuar praninë e saj diplomatike e kulturore në Shkodër. Përveç kësaj nga historia dhe politika është trajtuar shumë shpesh edhe çështja e interesit të shtetit serb për dalje në Adriatik, si pjesë e projekteve të ndryshme strategjike që nga shekulli i XIX. Në këtë kuadër Rusia është trajtuar në analizat historike si një aktor me interes të qëndrueshëm në rritjen e ndikimit të saj në Ballkan, dhe në sigurimin e aksesit strategjik drejt deteve të ngrohta, përfshirë Adriatikut.

Nga ky këndvështrim, prania konsullore në Shkodër mund të analizohet si pjesë e rrjetit diplomatik dhe institucional të Serbisë në rajon, i cili potencialisht mund të shërbejë për zgjerimin e komunikimit dhe ndikimit të saj në nivel lokal dhe rajonal. Në mënyrë të ngjashme, konsullata shqiptare në Luginën e Preshevës, duhet vlerësuar në kuadër të funksioneve të saj zyrtare konsullore dhe të kufizimeve që rrjedhin nga korniza ligjore dhe institucionale e shtetit pritës, Serbisë. Dhe natyrisht duke pasur parasysh spastr-

Shqetësimi ynë real është se ajo mund të shërbejë si një qendër e rëndësishme e veprimtarisë informative në funksion të interesave shtetërore të Serbisë, me pasojat të mundshme për sigurinë dhe interesat shqiptare. Ndërkohë që konsullata shqiptare në Luginën e Preshevës, do të veprojë në një mjedis ku institucionet e sigurisë serbe ushtrojnë kontroll të gjerë. Shto këtu spastrimin e heshtur etnik të shqiptarëve atje. Për këtë arsye, është vështirë të besohet se ajo do të ketë hapësirën e duhur për të zhvilluar një veprimtari të lirë dhe efektive në mbështetje të gjuhës, kulturës dhe të drejtave kombëtare të shqiptarëve të Luginës, siç pretendojnë disa.

Prandaj, barazimi i këtyre dy konsullatave është një gabim serioz analitik. Njëra ndodhet në zemër të shtetit shqiptar, në një qytet me rëndësi të veçantë historike dhe strategjike, tjetra vepron në një mjedis ku liria e veprimit do të jetë domosdoshmërisht e kufizuar. Ndaj barazimi i këtyre dy konsullatave, nuk është diplomaci, por një kapitullim i pastër i shtetit shqiptar dhe ofendim i rëndë i inteligjencies kombëtare.

Ky vendim nuk duhet parë e as trajtuar si një gjest i zakonshëm diplomatik. Ky vendim i Qeverisë së Shqipërisë nuk mund të shihet thjesht si një akt diplomatik rutinë. Ai ngre shumë pikëpyetje mbi pasojat e mundshme strategjike dhe kërkon një vlerësim të kujdesshëm të rreziqeve dhe përfitimeve në raport me interesin tonë madhor kombëtar. Ky akt duhet analizuar në dritën e historisë, përvojave politike e diplomatike, në dritën e interesave afatgjata gjeopolitike në Ballkan. Si dhe detyrimit që çdo qeveri shqiptare ka, në radhë të parë, e mbi të gjitha, për mbrojtjen e interesit kombëtar.

Nuk duhet ndonjë njohje e thellë historike, politike e diplomatike për t'a njohur qëllimin djallëzor serb dhe naivitetin shqiptar, për t'a pasur të qartë objektivin e këtij propozimi serb dhe prapa vine e tij. Nëse kjo ndodhë, atëherë padyshim në Shkodër, pra në kryeqytetin e Shqipërisë së Veriut, do të vendoset një stacion legal i shërbimit të sigurimit serb të BIA-s, një qendër e fuqishme spiunazhi, e cila ka prioritet destabilizimin e kombit shqiptar.

Ndaj është detyrë mbi detyrat, sa ka ende kohë, të anulohet ky vendim i rrezikshëm i cili cenon interesin tonë madhor kombëtar, duke qenë kapitullim i pastër i shtetit tonë dhe lojë e turpshme me kujtesën e popullit shqiptar dhe vetë inteligjencien e kombit tonë!

Sepse qeveritë vijnë e shkojnë, ndërsa kombi dhe interesi kombëtar është i përjetshëm.

Prof. Dr. LULJETA PULA
31 korrik 2026



serbe. Një nga rastet më të njohura është dokumentari i Radio Televizivja Srbije me titull "Skadar- srpska prica" ("Shkodra-histori serbe"), transmetuar fillimisht në vitin 2010 dhe i ritransmetuar më vonë.

Më pas, shumë herë është propaganduar hapur në media dhe disa institucione serbe të kulturës, se liqeni i Shkodrës dhe zonat përreth, përfaqësojnë një hapësirë të trashëgimisë kryesisht serbe, mbështetur në praninë historike të kishave ortodokse dhe periudhave të sundimit serb. Dhe atyre, që hapur kanë pretendime territoriale ndaj Shkodrës tonë, kryeqytetit të Shqipërisë Veriore, ne duam t'u ofrojmë konsullatë në Shkodër?!!

Kjo nuk guxon të ndodhë, në asnjë mënyrë!!! E të mos flasim pastaj, për atë, se Kosova akoma sot, 27 vjet pas luftës, kërkon fëmijët e vet në varrezat masive të Serbisë! E ne t'i japim konsullatën Serbisë në Shkodër?!!!! Është normale pastaj të besohet se ka një vazhdimësi midis këtyre narrativave historike, që nuk kanë pushuar asnjëherë, dhe interesit të Serbisë së

imin etnik të heshtur e malicioz, të shqiptarëve, që Serbia vazhdon t'a ushtrojë në Luginën e Preshevës!

Ka argumentime boshe e të pabaza, se kjo marrëveshje e këmbimit të konsullatave është e mirë, dhe me interes për ne. Sepse, sipas tyre shteti shqiptar do të jetë pranë mbi 100 000 shqiptarëve të Luginës, ndërsa Serbia pranë 50 serbëve në Shkodër. Kjo qasje ndaj kësaj çështjeje, është e reduktuar, e degjeneruar, e zvetënuar dhe e deformuar.

Serbia nuk ka nevojë për konsullatë në Shkodër. Serbia nuk vjen në Shkodër për t'u kujdesur e për t'i mbështetur 50 serbë. Konsullata e saj do të ketë një rol shumë më të gjerë se shërbimet konsullore. Konsullata nuk është vetëm institucion që ofron shërbime administrative. Ajo është në radhë të parë, instrument i politikës së jashtme të një shteti. Prandaj hapja e një konsullate serbe në Shkodër nuk mund të vlerësohet vetëm mbi bazën e numrit, aq më pak të këtij numri simbolik të qytetarëve serbë që jetojnë atje.

E drejta e përdorimit të gjuhës Shqipe në Maqedoninë e Veriut

Prenda Sejdia

Gjuha si atdheu i padukshëm:

Filozofia e një të drejte që nuk mund të mohohet kurrë.

Gjuha nuk është vetëm një mjet komunikimi. Ajo është kujtesa e një populli, frymëmarrja e historisë së tij dhe forma më e thellë e ekzistencës kolektive. Kur një njeri humb gjuhën, ai nuk humb vetëm fjalët; ai humb mënyrën se si e kupton botën. Ndërsa kur një popull i kufizohet e drejta për ta përdorur gjuhën e vet, nuk kufizohet vetëm komunikimi i tij, por cenohet vetë dinjiteti njerëzor.

Filozofi gjerman Martin Heidegger shkruante se: "Gjuha është shtëpia e qenies!"

Brenda kësaj metafore qëndron një e vërtetë universale; askush nuk mund të jetojë i lirë nëse nuk banon në shtëpinë e gjuhës së vet. Për shqiptarët në Maqedoninë e Veriut, kjo shtëpi ka kaluar nëpër periudha të gjata mbylljeje, kufizimesh dhe përpjekjesh për ta mbajtur derën hapur për brezat që vijnë.

Historia e shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut nuk është vetëm histori politike; ajo është edhe histori e mbijetesës gjuhësore. Për dekada me radhë, përdorimi i gjuhës shqipe është shndërruar në një betejë të vazhdueshme ndërmjet së drejtës natyrore dhe kufizimeve institucionale. Pikërisht për këtë arsye, çështja e gjuhës nuk mund të reduktohet në një debat administrativ; ajo është një çështje filozofike, juridike dhe njerëzore. Një popull mund të pushtohet territorialisht, por pushtimi më i thellë fillon atëherë kur fillojnë të zbehen fjalët e tij.

Gjuha si e drejtë natyrore dhe juridike

Filozofia klasike e së drejtës natyrore, që nga John Locke deri te Jean-Jacques Rousseau, pranon se ekzistojnë të drejta që nuk burojnë nga shteti, por nga vetë natyra njerëzore. Ndër to është edhe e drejta për të folur gjuhën amtare.

Shteti nuk e krijon këtë të drejtë; ai vetëm ka detyrimin ta njohë dhe ta mbrojë.

Prandaj përdorimi i gjuhës shqipe në administratë, në arsim, në universitete dhe në jetën publike nuk është privilegj i një komuniteti. Ai është realizim i një të drejte themelore njerëzore. Edhe filozofi Hans-Georg Gadamer e konsideronte gjuhën si hapësirën ku ndërtohet kuptimi

i botës. Nëse njeriut i mohohet gjuha, i mohohet edhe mënyra për ta interpretuar realitetin.

Historia e pengesave:

Shqiptarët në Maqedoninë e Veriut kanë kaluar periudha të ndryshme diskriminimi në përdorimin e gjuhës. Në dekada të ndryshme janë shfaqur kufizime në përdorimin e gjuhës shqipe në administratën shtetërore;

mungesën e dokumentacionit dygjuhësh; kufizimin e përdorimit të shqipes në shumë institucione publike; pengesa në arsimin e lartë; vështirësi në përdorimin e simboleve kombëtare dhe identitare.

Kulmi i këtyre problemeve u bë një nga shkaqet që çuan në konfliktin e vitit 2001, pas të cilit u arrit Marrëveshja Kornizë e Ohrit, e cila njohu nevojën për zgjerimin e të drejtave gjuhësore të komuniteteve. Megjithatë, filozofia na mëson se një e drejtë e shkruar nuk është domosdoshmërisht një e drejtë e jetuar.

Arsimi si tempulli i gjuhës:

Nëse gjuha është shtëpia e qenies, atëherë shkolla është arkitektja e saj.

Një fëmijë nuk mëson vetëm alfabetin. Ai mëson të jetë vetvetja. Prandaj



arsimi në gjuhën shqipe nuk është vetëm proces pedagogjik; ai është proces identitar. E drejta për të studiuar në gjuhën amtare mbrohet nga shumë instrumente ndërkombëtare. Ndër më të rëndësishmet janë: - Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (1948), e cila garanton barazinë dhe mosdiskriminimin. Pakti Ndërkombëtar për të - Drejtat Civile dhe Politike, sidomos neni 27, që garanton të drejtën e pakicave për të përdorur gjuhën e tyre.

- Konventa Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare e Këshilli i Evropës.

Karta Evropiane për Gjuhët Rajonale ose të - Pakicave, që synon mbrojtjen dhe promovimin e gjuhëve. Këto dokumente e konsiderojnë arsimin në gjuhën amtare jo si privilegj politik, por si standard demokratik.

- Universitetet shqiptare në Maqedoninë e Veriut kanë pasur rol vendimtar në ruajtjen e identitetit kulturor dhe shkencor të shqiptarëve. Megjithatë, edhe zhvillimi i tyre është shoqëruar me sfida institucionale, politike dhe financiare. Një universitet nuk prodhon vetëm diploma. Ai prodhon kujtesë.

- Ligji dhe realiteti:

Në vitet e fundit janë bërë hapa të rëndësishëm në zgjerimin e përdorimit zyrtar të gjuhës shqipe në Maqedoninë e Veriut.

- Ligji për Përdorimin e Gjuhëve ka synuar zgjerimin e përdorimit të shqipes në shumë institucione shtetërore.

- Por çdo ligj vlen aq sa zbatohet. Në shumë raste raportet e organizatave vendore dhe ndërkombëtare kanë evidencuar se ekziston dallim ndërmjet dispozitave ligjore dhe praktikës së përditshme.

Filozofi Paul Ricoeur shkruante se identiteti ndërtohet përmes rrëfimit.

Por çdo rrëfim fillon me gjuhën. Kur gjuha pengohet, pengohet edhe rrëfimi.

Kur rrëfimi ndërpritet, dëmtohet identiteti. Prandaj diskriminimi gjuhësor nuk është vetëm shkelje administrative. Ai është cenim i dinjitetit njerëzor.

Asimilimi nuk fillon gjithmonë me dhunë. Shpesh fillon me heshtje.

Fillon kur një fëmijë turpërohet të flasë gjuhën e nënës.

Fillon kur qytetari ndjen se gjuha e tij nuk ka të njëjtën peshë para ligjit.

Fillon kur administrata e trajton gjuhën si problem dhe jo si pasuri.

Gjuha si urë dhe jo si mure ...

Një shtet demokratik nuk dobësohet nga shumëgjuhësia.

Ai forcohet prej saj. Pluralizmi gjuhësor nuk cenon unitetin shtetërorë.

Përkundrazi, ai ndërton besim ndërmjet qytetarëve. Shqipja në Maqedoninë e Veriut nuk është gjuhë e huaj.

Ajo është gjuhë e një populli autokton që ka ndërtuar historinë, ekonominë, kulturën dhe jetën e këtij vendi. Njohja e saj nuk është lëshim politik.

Është drejtësi.

Së fundmi:

E drejta për përdorimin e gjuhës shqipe nuk është kërkesë sentimentale dhe as privilegj etnik. Ajo është një e drejtë juridike, kushtetuese, ndërkombëtare dhe universale, e lidhur pazgjidhshmërisht me dinjitetin e njeriut. - Një shtet demokratik matet jo nga fuqia për të imponuar një gjuhë të vetme, por nga aftësia për t'i mbrojtur të gjitha gjuhët që jetojnë brenda tij.

- Shqiptarët në Maqedoninë e Veriut kanë të drejtë të mësojnë, të studiojnë, të komunikojnë, të administrohen dhe të jetojnë në gjuhën e tyre amtare, sepse kjo e drejtë nuk buron vetëm nga ligji, por nga vetë qenia njerëzore.

Gjuha nuk është vetëm tingull.

Ajo është kujtesë.

Nuk është vetëm alfabet.

Ajo është identitet.

Nuk është vetëm e kaluar.

Ajo është e ardhmja.

Dhe sa herë që një fëmijë shqiptar hap librin e parë në gjuhën shqipe, nuk mëson vetëm shkronjat. Ai dëshmon se një popull vazhdon të ekzistojë, sepse vazhdon të flasë me zërin e vet.

REDAKSIA

Kryeredaktore: Klodjana Serraj
Prele Milani, Lazer kodra, Lazer Stani, Roza Pjetri,
Suela Ndoja, Zef Nika, Vuksan Kola, Zef Gjeta, Ledia
Dushi, Leke Sokoli, Edmond Tërthorja, Lulash Brigja,
Vilson Peshkaj, Prele Shytani, Zef Bari, Gjon Fierza,
Ndue Ziçi, Gasper Marku, Mark Gjeka.

MUNDËSOI BOTIMIN,
BAR – RESTORANT
“BLINI”,
ME PRESIDENT
PJETER GJETA

